

DI
DRITA ISLAME

Lindja e Krenarisë së
Njerëzimit (a.s.)



Revista Drita Islame në versionin online...

www.dritaislame.al



TEOLOGJI

BOTA JONË

REFLEKSIONE

TRASHËGIMI KULTURORE

FAMILJA

PERSONALITETE



www.dritaislame.al

“Drita islame”
Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë

DREJTOR
Dorian Demetja

KRYEREDAKTOR
Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA
Erzen Carja

KONTAKT:
Tel/fax 04 223 04 092
E-mail: info@dritaislame.al

Viti XXXIII i botimit
Nr. 04 (491)
Prill, 2024

ISSN 2226-7115



Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen,

nuk paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.

Materialet e sjella në redaksi,
pavarësisht nëse botohen apo jo,
nuk i kthehen autorit.

PËRMBAJTJA

4 I dashuri prej Zotit vinte me dritë / Mehmet Disha

6 Katër cilësitë më të vështira / Elton Karaj

8 Lajme / Aktivitete



12 Disa pasazhe nga dijetarë myslimanë
shqiptarë rreth Profetit Muhamed (a.s.) / Redaksia

16 Kreu “Ja-Sin”, përmbajtja dhe vlerat / K. S. Hoxha

20 Humanizmi i Profetit Muhamed (a.s.) / Dorian Demetja

22 Kur’ani është dritë / Mehmet Ates

24 Mjek i sëmundjeve morale e shoqërore / Remzi Sh. Gani

26 Zemra, thelbi i qenies njerëzore / Abdullah Bulku


28 Ngadhënjimi i Mekës / M. Jusuf Kandeheui



32 Metodologjia e Ebu Hanifes në nxjerrjen e dispozitave / Jusuf Zimeri

34 Osman Myderrizi (1891-1973) / Personalitet

38 Muhamedi (a.s.) - Krenaria e njerëzimit / Jonida Hoxha



I dashuri prej Zotit vinte me dritë

Të flasësh për Muhamedin a.s., do të thotë të marrësh në konsideratë jetën e një burri, i cili u dallua për karakteristikë të veçanta e të papërsëritshme, që u shfaqën tek ai qysh në moshë të njomë dhe me kalimin e viteve do të bëheshin veti të përsosura, nga të cilat u emetuan dhe do të emetohen rrezatimet më humane për të gjithë brezat. Në lidhje me moralin e Muhamedit a.s., Allahu në Librin e Tij thotë: "Vërtet, ti je në shkallën më të lartë të moralit", ndërsa vetë i Dërguari i Allahut ka thënë: "Jam dërguar për të plotësuar moralin më të nderuar" dhe "Mua më ka edukuar Zoti im me edukatën më të bukur".

Fraza 'moralet më të nderuara' është e shkurtër, por që në personin e Muhamedit a.s. përfshin kuptime të thella; përfshin dëshirën e tij për të mirën e për të vërtetshmen dhe veprimin sipas këtyre parimeve; përfshin trajtimin e të tjerëve me dashuri e butësi; përfshin mbajtjen e lidhjeve me njerëzit e gjakut, bamirësinë ndaj fqinjit, etj.

Moralet më të përsosura të Muhamedit a.s. përfshijnë takimin e të tjerëve me fytyrë të qeshur, largimin e zemërimit, shoqëruar me ndjenjën e turpër. Ai përshëndeste ata që i njihite e ata që nuk i njihite me fjalën e bukur e të ëmbël 'Selam - Paqë', pa lënë mënjanë bujarinë për t'u ardhur në ndihmë të tjerëve me çfarëdo që t'i ndodhej. Njëkohësisht, vetitë më të plotësuar të ky Profet, përfshijnë frenimin e zemërimit e të

prepotencës, ashtu siç përfshijnë faljen ndaj atij që i bënte keq dhe përgjigjen me të mirë ndaj vetë të keqes; përfshijnë pastrimin e plotë të zemrës nga urrejtja, qëndrimin larg nga veprimet e kohës së injorancës përpara Islamit, heqjen dorë nga veprimi sipas dëshirës dhe nga diskutimet e kota.

Ai jo vetëm që përgëzonte për të mirë, por vazhdimisht i lutej Allahut që e mira të mbizotëronte kudo e kurdo. Pejgamberi asnjëherë nuk u shkaktoi dëme të tjerëve as me fjalë, as me veprë dhe as me gjykimin e tij.

Muhamedi a.s. ndiente dhimbje për dhimbjet e njerëzve dhe gëzohej për gëzimet e tyre. Në derën e tij trokisnin të gjithë, të huajt që kishin nevojë për përkrahje materiale e morale dhe ata që, për një arsye apo një tjetër, kalonin nëpër situata të vështira. Të gjithë gjenin te Muhamedi mbështetjen e duhur dhe ai qëndronte përkrah tyre, jo për t'iu imponuar, por vetëm për t'i ndihmuar dhe për të mos lënë që vështirësia që kalonin t'i tërhiqte në rrugën e gabuar.

Për sa i përket edukimit fizik, profeti Muhamed a.s. është modeli më i përkryer në të gjitha veprimet që njeriu mund të kryejë gjatë jetës. Tek ai mishërohej fjala me veprimin. Ai asnjëherë nuk e la pas dore higjienën personale, asnjëherë nuk hëngrir sa të ndiente rëndim në stomak. Porositë e këshillat e tij për shëndetin përbëjnë një kapitull më vete, prandaj dijetarët myslimanë i kanë sistemuar në libra të



veçantë.

Me të tilla veti e pajisi Allahu Profetin e Tij, sepse ai do të ftonte në të vërtetën, për atë të vërtetë për të cilën Allahu na ka krijuar, për të adhuruar vetëm të madhin Zot. Morali i tij i bukur dhe i plotësuar linte gjurmë në thirrjen që ai u bënte njerëzve për të lënë udhën e gabuar të idhujtarisë dhe për të besuar e adhuruar vetëm Allahun, Zotin Një e të Vetëm.

Me të tilla cilësi të bukura e pajisi Allahu të Dërguarin e Tij fisnik, kur thotë: "Ti ishe i butë ndaj tyre ngase Allahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemërgur, ata do të largoheshin prej teje, andaj tregohu zemërgjerë ndaj tyre, kërko për ata që t'u falen mëkatet dhe këshillohu me ata për të gjitha çështjet (për punët e kësaj bote) dhe, kur të vendosësh, mbështetu vetëm në Allahun; me të vërtetë Allahu i do ata që kërkojnë mbështetjen e Tij."

Allahu e pajisi Muhamedin a.s. me vetinë e fjalës, sepse me thirrjen që do të bënte për të vërtetën e për t'u udhëzuar në rrugën e drejtë, ai detyrimisht do të përballonte reagimet e kundërshtimet më të ashpra. Prandaj Allahu, përpara se ta ngarkonte me misionin profetik, i dhuroi një moral të tillë që pajtonte zemrat, që qëndronte më lart se dëshirat dhe, në sajë të tij, Muhamedi a.s. dëshmonte vetëm të drejtën, kishte dashuri për njerëzit e tij, i afrohej mikut dhe nuk shfaqte armiqësi ndaj askujt. Ai ishte shembulli i modestisë dhe

i pastërtisë shpirtërore e fizike në mesin e njerëzve që e rrethonin, goftë në fjalë, në vepër e në mendime.

Profeti a.s. kurrë nuk iu nënshtrua dëshirave e hamendjeve, ai ishte i drejtë e besnik, i ndihmonte të gjithë, sidomos të pafuqishmit e nevojtarët. Ai e falte këdo që i bënte atij padrejtësi, por nuk toleronte kurrsesi shkeljen e urdhrave të fesë së Allahut, ose të nëpërkëmbej nderi i dikujt. Për të tilla çështje Profeti ishte i paepur dhe tepër i qartë në mbrojtjen e ligjit të fesë e të vlerave morale.

Në çdo pikëpamje të jetës, ai ishte vetëm pozitiv, sepse morali i tij nuk mund të pajtohej me negativën. Gjithmonë kërkonte të mirën, bënte vetëm të mirën dhe qëndronte larg së keqes. Edhe në punët personale e të sjelljes së tij në familje, Profeti mbetet modeli i kryefamiljarit të kujdesshëm dhe i bashkëshortit ideal. Edhe në punët e tregtisë që ushtronte dhe me të cilën siguronte mjetet e jetesës, Muhamedi a.s. ishte tepër i ndershëm, tolerant dhe shumë i durueshëm.

Të gjitha këto morale të bukura u shtrinë në gjerësi e në thellësi akoma më shumë pasi u ngarkua me misionin profetik.

Mehmet Disha

Katër cilësitë MË TË VËSHITIRA

Nxtoni drejt faljes së gjynaheve nga Zoti juaj dhe Xhenetit, hapësira e të cilit është sa qiejt e Toka dhe që është përgatitur për të devotshmit.” (Al Imran, 3/133)

Feja jonë e dashur na ka ngarkuar disa përgjegjësi dhe ajo që pritet prej nesh është që ato të zbatohen sipas kriterëve në maksimumin e mundshëm. Këto përgjegjësi i japin jetës sonë një drejtim të caktuar, duke na orientuar kah mirësitë. Në momentin që këto përgjegjësi kryhen në formën e duhur, atëherë gjejmë lumturi, por kur ato anashkalohen ose neglizhohen, atëherë mos në këtë botë, në botën tjetër do na dalin përpara si mangësi dhe ndoshta edhe do të ndëshkohemi për këtë. Fundja, çdo gjë është në dorë të vullnetit të gjithsecilit prej nesh dhe në shumicën e rasteve jeta ecën edhe me neglizhime.

Jemi të qartë që çdo përgjegjësi apo detyrë ka vështirësinë e saj. Të marrësh abdes pesë herë në ditë, të falësh namazin, të agjërosh në ditët e gjata dhe të nxehta të verës nga mëngjesi gjer në mbrëmje, të ndash me të tjerët prej asaj që ke fituar me djersën e ballit, t’ua plotësosh të gjitha të drejtat prindërve pa iu ankuar atyre qoftë edhe njëherë të vetme janë të gjitha punë që, po t’i shohësh mirë, secila prej tyre ka vështirësitë e veta shumë të mëdha. E megjithatë, mes të vështirave gjejmë edhe më të vështirat, të cilat në një fjalë të urtë, që i atribuohet Aliut r.a., janë radhitur kështu: “Këto janë katër cilësitë që janë më të vështirat për t’u arritur: 1. Të falësh kur je i nevrikosur; 2. Të tregosh bujar edhe në kohët kur je ngushtë; 3. Ta ruash nderin edhe kur je vetëm për vetëm me mëkatin; 4. T’ia thuash të vërtetën ashtu siç është edhe njeriut të cilit i frikësohesh apo je i lidhur në interesa me të.”

1. Të falësh kur je i nevrikosur

Të mundësh zemërimin dhe të falësh tjetrin në ato çaste kur nevrikosja dhe zemërimi shkumëzojnë si magmë është me të vërtetë shumë e vështirë, por

një punë e fisme. Kur’ani e ka trajtuar gjerësisht këtë çështje në suren Al Imran, ku Allahu i Madhëruar thotë: “Nxtoni drejt faljes së gjynaheve nga Zoti juaj dhe Xhenetit, hapësira e të cilit është sa qiejt e Toka dhe që është përgatitur për të devotshmit” (3/133). Cilët janë këta të devotshëm? Përgjigja e kësaj pyetjeje vjen në ajetin vijues: “Ata të devotshëm, që shpenzojnë për Allahun, si në kamje, si në kohët kur ndihen ngushtë; që edhe kur janë të nevrikosur (megjithëse kanë forcë për t’u hakmarrë) e shtypin zemërimin dhe i falin të tjerët (njerëzit).” (3/134)

Për një njeri të qetë, që nuk shqetësohet lehtë prej asaj që ndodh përreth, që njerëzit e duan dhe e vlerësojnë, është shumë e lehtë që të jetë falës. Arritje e vërtetë është kur dikush shqetësohet prej dikujt, i bëhet ndonjë padrejtësi prej tij, nevrikoset ku s’ka më, por, prapëseprapë nuk e humb, përkundrazi, e përdor siç duhet vullnetin e tij dhe, në vend që të përgjigjet me të njëjtën monedhë, tregohet falës, duke u mbështetur kështu në atributin “Afuu/Falës” të Mëshirëplotit.

2. Të tregosh bujar edhe në kohët kur ndihesh ngushtë

“Të tregosh bujari edhe në kohët kur je ngushtë” na tregon vështirësinë dhe rëndësinë njëherësh, të sjelljes prej bujari edhe në kohët kur të ka pllakosur nevoja dhe ndihesh ngushtë për vete. Bujaria e njeriut të pasur, të cilit nuk i pakësohet asgjë prej stokut apo pasurisë nga ajo që u fal të tjerëve është e lehtë. E çfarë humbet nëse jep një monedhë të vetme dikush që zotëron mijëra të tilla?! Ashtu si falja në çastet e zemërimit i bën thirrje emrit “Afuu/Falës” të Allahut xh.sh., edhe bujaria e treguar në kohë të vështira i bën thirrje emrit “Xheuad/paskajshmërisht Bujar” të Tij.

Në njëfarë mënyre, prej nesh kërkohet që të pajisemi me ndjenjën “të menduarit për të tjerët para vetes”. Por shembujt tanë më të mirë, me veprat e tyre, përsëri na



treguan që edhe më e vështira është e realizueshme. Kur mekasit emigruan në Medinë, gjetën ndihmë dhe mbështetje morale e materiale nga vendasit dhe në këtë formë një grup u quajt muhaxhir e tjetri ensar. Kjo sjellje mes tyre u kurorëzua me vlerësimin hyjnor, të cilin Allahu xh.sh. e ka skalitur në Kur'an me fjalët: "Ata që banojnë në Medinë dhe që e kanë pranuar besimin qysh më parë, i duan mërgimtarët që vijnë në Medinë dhe në zemrat e tyre nuk ndejnë kurrfarë rëndimi, për atë që u është dhënë atyre, por duan t'u bëjnë më mirë mërgimtarëve sesa vetes, edhe pse vetë janë nevojtarë. Kushdo që ruhet nga lakmia e vetvetes, me siguri që do të jetë fitues." (Hashr, 59/9)

3. Ta ruash nderin edhe kur gjendesh fare pranë mëkatit

Në një hadith të tij i Dërguari i Allahut a.s. thotë se në Ditën e Kiametit, kur nuk do të ketë askund hije, janë shtatë grupe njerëzish, të cilëve do t'u bëhet hije mbi krye dhe pjesëtari i njërit prej tyre do të jetë ai njeri, i cili edhe pse femra të bukura dhe të pasura e kanë thirrur në mëkat, ai i ka refuzuar menjëherë duke thënë: "Jo, unë i frikësohem Allahut!"¹

Në njëfarë kuptimi, të dukesh i ndershëm në prani të njerëzve është diçka e lehtë, sepse, në një ambient kur sytë e njerëzve janë aty dhe ju i shikoni, është e vështirë të hyhet në mëkat. Kurse një njeri që e gjen veten të mbërthyer prej kurthit të mëkatit, ku personi tjetër përpiket ta nxjerrë nga binarët, e ka shumë më të vështirë që t'i bëjë ballë tundimit, sepse në një çast të tillë mëkati mund të të lërë pa mend dhe mund të ta errësojë shikimin. E këtu të fituarit janë përsëri ata që ndjekin shembullin profetik të Jusufit a.s. Kur'ani na tregon: "Por ajo, në shtëpinë e së cilës gjendej ai, nisi ta joshë në kundërshtim me dëshirën e tij. Ajo ia mbylli të gjitha dyert dhe tha: 'Jam e gatshme për ty!' Kurse ai

tha: 'Allahu më ruajt! Me të vërtetë, Zoti im ka treguar kujdes për mua dhe, pa dyshim, keqbërësit nuk do të shpëtojnë kurrë'". (Jusuf, 12/23) Qëndrimi i palëkundur, me ngurtësinë dhe qëndrueshmërinë në të tilla pozita, është diçka që kërkon një vullnet të çeliktë. E, nuk ka dyshim se ai që arrin t'i bëjë ballë një provimi të këtillë po aq të madh ka për të pasur edhe shpërblimin.

4. Të thuash të vërtetën edhe në çastet më të vështira

Dhe së fundmi, Aliu r.a. na tregon se vepra e katërt më e përkorë është "t'ia thuash të vërtetën ashtu siç është edhe njeriut të cilit i frikësohesh apo je i lidhur në interesa me të". Ky është një fenomen më se i përhapur, ku frika dhe interesi ndaj dikujt, bëjnë që ndonjëherë personi të heshtë përballë pad rejtësisë, ndonjëherë thjesht për të fshehur të vërtetën, dhe ndonjëherë tjetër e bën që t'i bashkohet karvanit të mëkatarëve, duke fryrë edhe më tepër gënjeshtrenë dhe mashtrimin. E kështu, vjen një kohë, ku ai jeton mbi shtratin e gënjeshtreve, dhe e vërteta apo e drejta për të nuk kanë më rëndësi. Pikërisht këtu, jeta e tij është kthyer në një gënjeshtëri totale dhe në momentin që shpërthen e katapulton atë drejt vendit që meriton. Zot na ruaj nga të tilla mëkate, që me shprehjen e Profetit a.s. të kthejnë në një shejtan pa gjuhë.

Shpërblimi dhe të mirat e punëve jepen ndryshe sipas kohës dhe hapësirës në të cilën ato kryhen. E shkak i mirëfilltë për shumëfishimin e shpërblimit të punëve, që bëhen me më shumë mundime dhe vështirësi, mund të jetë veçse ruajtja e të njëjtit sinqeritet përherë, pa u përfshirë në kurrfarë ankimesh të drejtpërdrejta apo të tërthorta qofshin.

Elton Karaj

1. Buhari, zekat, 16; Muslim, zekat, 91.



1

KËSHILLI I PËRGJITHSHËM I KOMUNITETIT MYSLIMAN TË SHQIPËRISË ZHVILLON MBLEDHJEN PËR ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË RI

Këshilli i Përgjithshëm i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, zhvilloi në ambientet e Medresesë së Tiranës, mbledhjen e tij të zakonshme për zgjedhjen e kryetarit të ri të institucionit.

Pas votimit të anëtareve të Këshillit të Përgjithshëm, H. Bujar Spahiu u rizgjedh Kryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë për një mandat të dytë 5-vjeçar.

Kandidaturat për kryetar të institucionit ishin: z. Eduard Shefki, Administrator i Myftinisë së Durrësit, z. Emirjon Vathaj, Myfti i Beratit dhe z. Bujar Spahiu, kryetar aktual i KMSH-së.

Fillimisht kandidatët prezantuan platformat dhe vizionin e tyre për të ardhmen e institucionit. Gjatë prezantimit pati diskutime dhe pyetje të ndryshme në lidhje me programin por edhe mbi çështje që preokupojnë institucionin dhe besimtarët.

Votimi për zgjedhjen e kryetarit u zhvillua në mënyrë të fshehtë. Nga 94 anëtarë të këshillit, votuan 92 prej tyre pasi 2 anëtarë mungonin. Fitues me shumicë votash u shpall z. Spahiu me 82 vota. Proçesi i votimit u zhvillua rregullisht konform normave statutore dhe nuk pati asnjë kontestim.

Më pas, z. Spahiu me dorë mbi Kur'anin Famëlartë, bëri betimin konform statutit përpara anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm, si vijon: "Beto hem në emër të Allahut, se do të vazhdoj me besnikëri e përkushtim urdhrat e Islamit, do të punoj me ndërgjegje të plotë islame për lartësimin e fesë së Allahut, do të zbotoj me përpikmëri Statutin dhe Rregulloren e Komunitetit Mysliman, dhe do të punoj me ngulm për forcimin e ndjenjës kombëtare e atdhedashurisë ndër myslimanët e Republikës së Shqipërisë. Allahu më ndihmoftë!"





2

KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPËRISË, SHTRON IFTARIN E PARË

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, shtroi iftarin e parë, iftar i kthyer tashmë në traditë për institucionin, në të cilin morën pjesë besimtarë të shumtë, myftinj, imamë, personalitete publike, ambasadorë, gazetarë, politikanë, zyrtarë qendror, lokal etj. Ky iftar u shtrua në ambientet e "Tirana International Hotel".

Në fjalën e tij të rastit, Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, pasi falenderoi të pranishmit për pjesëmarrjen dhe ju uroi agjërim të lehtë e të pranuar të gjithë besimtarëve, u ndal në vlerat morale e shpirtërore që kultivon ky muaj i begatë tek të gjithë ne.

Më tej, të pranishmit konsumuan iftarin e parë të shtruar nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë në këtë muaj të begatë.

3

IMAMI DR. HAMED EL-UAHIBI VIZITË NË SHQIPËRI

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim në zyrën e tij, Dr. Hamed el-Uahibi, Imam në Rijad, kryeqytetin e Mbretërisë së Arabisë Saudite dhe lektor universiteti.

Me ftesë të kryetarit Spahiu, Dr. Hamed el-Uahibi, ndodhet në Shqipëri për t'u prirë besimtarëve në myftini dhe xhami të ndryshme të vendit në namazin e teravive për më shumë se gjysmën e muajit të bekuar të Ramazanit.





4

SHPORTA E RAMAZANIT 2024

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, në bashkëpunim me Qendrën Bamirëse dhe Humanitare “Mbreti Selman” dhe me koordinimin e Ambasadës së Mbretërisë së Arabisë Saudite në Tiranë, çelën në ambientet e “Medresesë Tiranë”, fushatën e bamirësisë në ndihmë të mbi 5300 familjeve me vështirësi ekonomike në mbarë vendin tonë.

Të pranishëm në ceremoninë e sotme, ishin: Nënkryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Tauland Bica, Ambasadori i Arabisë Saudite në Tiranë, z. Fajsal Gazi Hifdhi, Përfaqësuesit e Qendrës Humanitare “Mbreti Selman”, z. Faisal Alwahaibi, z. Fahad Aljunaidal, Drejtori i Medresesë Tiranë, z. Ndrëçim Gjimi, si dhe imamë e familjarë të ndryshëm.

Në fjalën e tij, nënkryetari Bica, falenderoi përfaqësuesit e qendrës “Mbreti Selman” dhe Ambasadorin e Arabisë Saudite në Tiranë, të cilët, për të 6-tin vit radhazi po bëjnë të mundur aplikimin e këtij projekti mjaft të rëndësishëm për familjet në nevojë përgjatë muajit të begatë të Ramazanit.

Ndërsa z. Fajsal Gazi Hifdhi, ambasador i Mbretërisë së Arabisë Saudite në vendin tonë theksoi gjatë fjalës së tij marrëdhëniet e shkëlqyera ndërmjet dy vendeve tona dhe përforcimin e tyre të vazhdueshëm nëpërmjet nismave të tilla, të cilat e gjejnë burimin të udhëzimit e Mbretit të Arabisë Saudite, Selman bin Abdulaziz dhe Princit të Kurorës, Muhamed bin Selman.

Fushata, ashtu si çdo vit tjetër, konsiston në shpërndarjen e pakove me ndihma të ndryshme ushqimore. Fillimisht pakot me nga 70 kg ushqime secila, do t’ju dorëzohen përfaqësuesve të KMSH-së në 35 rrethe të vendit, më pas, këta të fundit do t’ju shpërndajnë familjeve në nevojë.





5

KRYETARI I KMSH, H. BUJAR SPAHIU MERR PJESË NË KONFERENCËN NDËRKOMBËTARE ME TEMË: "NDËRTIMI I URAVE NDËRMJET MEDHHEBEVE ISLAME"

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, mori pjesë në konferencën ndërkombëtare me temë: "Ndërtimi i Urave Ndërmjet Medhhebeve (shkollave juridike) Islame", konferencë kjo e organizuar nga Liga e Botës Islame (RABITA) në Mekke të Arabisë Saudite, nën kujdesin e drejtpërdrejtë të Kujdestarit të Dy Xhamive të Sherjta, Mbretit Selman bin Abdulaziz Al Saud.

Në të morën pjesë krerë fetarë, myftinj, studiues dhe një numër i konsiderueshëm personalitetesh të shquara nga sekte të ndryshme islame.

Si një ndër referuesit me ftesë të posaçme nga Kreu i RABITA-s, z. Muhamed bin Abdulkerim el-Isa, kryetari Spahiu, ndau me të pranishmit temën: "Vlerat e përbashkëta islame dhe karakteristikat dalluese të medhhebeve".

Konferenca synon të përmirësojë mirëkuptimin dhe bashkëpunimin ndërmjet sekteve islame përmes takimit të tyre vëllazëror shkencor për t'i shërbyer qëllimeve të përbashkëta, veçanërisht në lidhje me çështjet madhore që kërkojnë unitetin e mendimit legjitim.

Gjatë këtij aktiviteti, kryetari Spahiu shoqërohej nga Nënkryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Lauren Luli dhe këshilltari i tij për marrëdhëniet me vendet arabe, z. Jamal al-Safarti.

Në kuadër të konferencës "Ndërtimi i Urave Ndërmjet Medhhebeve Islame", H. Bujar Spahiu, kryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, u prit në një takim të posaçëm nga Shkëlqesia e Tij, Muhamed bin Abdulkerim el-Isa, Sekretari i Përgjithshëm i Ligës së Botës Islame, në selinë e tij në Mekke të Arabisë Saudite.



DISA PASAZHE NGA DIJETARË MYSLIMANË SHQIPTARË RRETH PROFETIT MUHAMED (A.S.)

Të gjithë janë kandila të dritës së Profetit Muhamed
a.s.

Haxhi Vehbi Dibra

Hidhi një sy historisë islame dhe do të konstatosh vetë se Profeti Muhamed (a.s.) me qëndrimin, durimin, vullnetin dhe gjykimin e mprehtë, me gjuhën e ëmbël, me kurajën e pashembullt, që janë karakteristika të veçanta vetëm për këtë personalitet të jashtëzakonshëm, i mbështetur në Perëndinë e vetme që besonte, mundi të bëjë një revolucion të madh në kombin e tij që e gjeti fanatik, të demoralizuar, grindavec, injorant, barbar, gjakpirës, idhujtar e padisiplinuar. Dhe me këtë brumë, trajtoi, brenda një kohe të shkurtër një popull të ri, të bashkuar dhe të vëllazëruar, fetar të vërtetë, të qytetëruar e të pajisur me moral të lartë, të virtytshëm, të arsyeshëm e të disiplinuar.

Shkurt, çdo fenomen i natyrës, çdo ngjarje e gjithësisë, lulet, pemët, kënaqësitë, dëfrimet e shijet shpirtërore, lutjet, çuditë e natyrës, mrekullitë e shpirtit, zbulimet e shkencës, pozitat e larta, kategorizimi moral i njerëzve me grada të ndryshme, besnikë, të afërt e dashurues të Zotit, të gjitha janë fryt i pemës muhamedane, janë kandilë të dritës së tij me të cilën qëndrojnë në këmbë; të gjithë pinë ujë në lumin "Keuther". Me këtë del në shesh sekreti i ajetit të madhnueshëm: **"Nuk të kam dërguar për tjetër, veçse mëshirë për gjithësinë"**.

Sot ka lindur kryetari i të gjithë profetëve
Hafiz Ismet Dibra

Sot është përvjetori i orës fatbardhë që përuroi fillimin e periudhës më të shkëlqyeshme të historisë së "Rilindjes njerëzore. Po, sot është përvjetori i asaj ore në të cilën sipërfaqes së tokës, që është dëshmitare ngjarjesh e faktesh të panumërta të miliona viteve, iu bë dhurata më e madhe dhe më e plotë e mirësive të pafundme të Perëndisë së amshuar. Në këtë ditë Tokës, pra, iu bë nderi më i madh, duke u lëmuar prej gjurmës së atij që në të dy jetët është i nderuar e që njerëzia e ka pritur me padurim qysh në "Ezel". Ky mëngjes u bë i lumnueshëm, sepse në të lindi "trupi i bekuar" i Profetit Muhamed (a.s.), i cili, duke përmbledhur në vetvete, në mënyrë të plotë: thjeshtësinë e kulluar të "babës Adem", madhështinë hyjnore të Nuhut, vullnetin e papërkullor e plot sakrificë të Ibrahimit, dorëzimin e devotshëm të Ismailit, forcën morale të Jakubit, bukurinë tërheqëse të Jusufit, durimin heroik të Ejubit, grushtin e Musait, dashurinë udhëheqëse të Isait, u bë prijësi më i madh i njerëzimit.

Në këtë ditë erdhi në botë ai të cilit i madhi Zot i tha: "Sot e përsosa fenë tuaj për ju, dhe i plotësova mirësitë e mia mbi ju..."

Sot festojmë përvjetorin e asaj dite të madhe në të cilën ka lindur kryetari i gjithë profetëve, Hazreti Muhamedi (a.s.), që i mësoi njerëzisë shtyllën e fortë të

virtutit shoqëror e të paqes. Ai ka thënë: "Më i ndershmi gjyq është paqja" dhe "Në qoftë se kërkojnë paqe, pajtohu".

Po të kërkohet burimi i vërtetë i "drejtësisë", barazisë, lirisë e vëllazërisë", që janë katër shtylla të lumturisë njerëzore, ky burim do të gjendet në "ditën" e parë që ka filluar kjo festë madhështore e që kremtohet pa përjashtim në botën islame, sepse në këtë ditë ka lindur ai që është "mëshirë për gjithësinë"...

Koha kish nevojë për udhërrëfyes të udhës së Zotit Hafiz Ali Korça

Në mënyrë shumë të shkurtër duam të theksojmë se popujt e botës së asaj kohe kishin nevojë për një grusht që të trondiste fronet e mbretërve e të përmbyste themelet e sundimit tiranik të tyre, t'iu thyente hundët që i mbanin nga qielli, duke i marrë kombet e varfra nëpër këmbë dhe duke i përdorur si bagëti.

Kjo kohë kish nevojë për një zë që t'i sillte në vete të hutuarit, t'i zgjonte prej gjumit të madhështisë aristokratët kryelartë, duke iu treguar se demokratët e gjorë, që po shtypeshin nga këmbët e tyre të pamëshirshme, nuk ishin kafshë.

Kjo kohë kish nevojë për një udhërrëfyes, që njeriun ta tërhiqte në rrugën që ka pëlqyer Zoti, për t'i këputur hekurat e robërisë, që kishin nëpër këmbë e zverqe dhe për të arritur shkallën më të lartë njerëzore, duke gjetur mënyrën që sjell lumturi në të dy jetët...

Hazreti Muhamedi (a.s.) u rrit pa nënë e pa babë. Për të nuk u kujdes njeri për ta edukuar, u rrit midis një populli injorant, pranë një fisi që i falej statujave, të cilat, ka pasur raste që i krijonte prej ëmbëlsire dhe, pasi u faleshin, kur i merrte uria, shtroheshin e i hanin ato perëndi që patën krijuar vetë prej hallvash! Ata, pra, u faleshin ëndrrave e u shërbenin idhujve. Në këtë gjendje, pra, ishte mjedisi ku lindi. Por ai çdo ditë rritej nga trupi dhe forcohej nga trutë, nga edukata lartësohej dhe në popullin e Mekës që në djalëri mori titullin "i besueshmi". Kur mbushi të dyzetat ishte i perfeksionuar, kurse kombi i vet mbetej prapa; ndërsa ky lartësohej kombi shkonte poshtë; ky dëshmonte Zotin, ata këputeshin para statujave që vetë i kishin krijuar; ky në besim të saktë e të vërtetë, ata të mbytur nëpër moçalet e ëndrrave; ky shtyhej pas mirësive, ata pas të këqijave; ky fluturonte në qiell të dritës, të përparimit e të lartësimit, kurse kombet mbyteshin në pellgjet e errësirës...

Sot ka lindur krijesa më e zgjedhur Myderriz Sheh Qazim Hoxha

Perëndia i Plotfuqishëm, kur deshi të krijojë gjithësinë, botën e dukshme e të padukshme, më parë krijoi nga drita e vet hyjnore, dritën e Hazreti Muhamedit. Pra si profetët, shenjtorët dhe engjëjt, që janë shtyllat më të larta të

sovrانيتetit hyjnor, ashtu dhe çdo gjë tjetër ia detyrojmë mirëqenien e vet shpirtit të lartë të Hazreti Muhamedit (a.s.) dhe faqet e historisë që përmbajnë shenjat e para të lartësimit që ky ka treguar në çdo degë, janë argumente lëndore e inspirata hyjnore.

Fjalët profetike janë dëshmi e vërtetë se qëllimi i zbritjes së librave hyjnorë ka qenë, si të thuash, një parathënie për zbritjen e Kuranit, ndërsa dërgimi i vargut të profetëve të tjerë, ka qenë si pararojë për njoftimin e ardhjes së zotnisë dhe më të zgjedhurit të profetëve. Pra, të vërtetat që përbëjnë këto fjalë profetike, na bëjnë të kuptojmë se Hazreti Muhamedi (a.s.), që është brumi i mirësisë për të gjithë profetët, edhe në botën e pasosur, këta profetë do të përfitojnë nga shkalla e plotësimit të më të zgjedhurit të të gjithë krijesave, që është Hazreti Muhamedi (a.s.) e në këtë mënyrë nuk ka asnjë dyshim se ai është bërthama e rruzullimit e pema e të gjitha qenieve...

Njeriu duhet të njohë Perëndinë Haki Sharofi

...Hazreti Muhamedi (a.s.) u lind në Mekë më 20 prill 571 pas Krishtit, natën e hënë me 12 Rebiul-Evvel. U rrit jetim e pa shkollë. Kur u bë 40 vjeç i erdhi nga ana e Zotit misioni "Profet i kohëve moderne". Pas Hazreti Muhamedit (a.s.) nuk vjen profet tjetër. Misioni i tij vazhdoi 23 vjet. Brenda kësaj kohe bashkoi dhe qytetëroi kombin e vet, hodhi themelet e shtetit islam, që brenda një shekulli i përhapi rrezet e shkëlqyeshme të dritës së Islamit në hapësirën midis Atlantikut e maleve të larta të Himalajës, midis Oqeanit Indian dhe portave të perandorisë bizantine.

Hazreti Muhamedi (a.s.) soli nga Perëndia Kuranin e madhnueshëm, që është vepër filozofike-letrare e pashembullt.

Po të studiohet me kujdes Kurani i shenjtë, kuptohet se Hazreti Muhamedi (a.s.) nuk shpiku një fe të re, por nxori në shesh fenë e harruar të Hazreti Ibrahimit (a.s.). Ai ka thënë se "Feja është një e vetme", ajo që adhuron një zot të vetëm. Atë fe e kanë predikuar të gjithë profetët, por popujt e tjetërsuan, duke e deformuar fenë e Zotit. Hazreti Muhamedi (a.s.) me Kuranin e lartë, ua hoqi bishtat e prapashtesat, i thjeshtoi e i reformoi, duke i përcjellë në origjinë me emrin "Islam".

Kur Zoti i krijoi njerëzit në jetën e palëndë, u tha: "A nuk jam unë Zoti juaj?" "Si urdhëron", iu përgjigjën të gjithë. "Atëherë, pra, dilni në jetën lëndore dhe provojeni me vepra se jeni të sinqertë!" Prandaj njeriu vjen e shkon në këtë jetë. Por ai duhet të përmbushë misionin e vet duke njohur Perëndinë dhe çdo vepër ta bëjë për Perëndinë, kurse çdo punë duhet t'ia kushtojë Perëndisë, se vetëm kështu zbatohet "traktati i amshuar".

Mrekullia më e madhe është se vetë Hazreti Muhamedi (a.s.) bëhet model ideal për të gjitha veprimet e njerëzisë. Ai në teori e në praktikë na shfaqet "politikan" e "administrator" i përsosur, "gjeneral" i mbaruar, "sociolog", "ekonomist",

“tregtar” pa asnjë të metë, “filozof” dhe “edukator” me doktrinën të plotë e të pagabueshme. Doktrina e tij është e vetmja që mund t’i zbrërthejë problemet e mëdha e shumë të komplikuar që shqetësojnë njerëzinë.

Jeta e mrekullueshme e profetit të madh të Islamit ende nuk është analizuar sa duhet. Kushdo që studion biografinë e tij habitet e nuk arrin të kuptojë se si i ka realizuar gjithë këto vepra brenda një kohe të shkurtër...

Lindja e Profetit... Imam Vehbi Ismaili

Ne jemi sot në muajin e Rebiul-Evvelit, në muajin që neve kremtojmë një prej ditëve me rëndësi të popullit musliman. Në të përkujtojmë ditëlindjen e Pejgamberit Muhamed (a.s), ditën që erdhi në këtë botë ai që e dërgoi Zoti mëshirë për të gjithë gjithësinë.

Ç’mund të thotë njeriu që të përkujtojë Pejgamberin Muhamed, që është zotëria i njerëzisë në të tërë kohët e shekujt? Si mund të cilësohet një oqean i tillë nga një pikë? Ose si mundet xixëllonja të përfaqësojë dritën e diellit? Është e pamundur që për një njeri sado orator e i shkolluar që të jetë, në një kohë të shkurtër sikur mbahen fjalimet në këtë rast, të përshkruajë e të flasë për Pejgamberin Muhamed (a.s.) të cilin e ka lavdëruar vetë Zoti duke thënë: “Me të vërtetë ti (o Muhamed) ke moralin më të lartë”. Puna që bën një person në raste të tilla është sikur të dojë të zbrazë një oqean me një lugë.

Megjithatë nuk mund të lihet ky rast pa këputur disa lule nga kjo lulishte, jeta e Muhamedit (a.s.), ku secila lule është më e bukur se tjetra; ne këtu do të paraqesim fluturimthi si një shirit fotografik disa aspekte të jetës së tij. Zoti na ndihmoftë.

Lindja e Muhamedit (a.s.) qe sihariq për ringjalljen e së vërtetës, që nuk njihet ngaqë tërë botën e kish mbuluar errësira dhe paralajmëruese e ardhjes së mbarësisë e mirësisë të cilën kishte kohë që bota e priste, që me të të zbardhte një ditë e re me vlera të larta e ideale të shkëlqyeshme, të zhdukte e të mposhte shtypjen që luante nën të njerëzimi.

E dërgoi Zoti Muhamedin në një kohë kur njerëzia kishin humbur rrugën e drejtë, mendjet dhe shpirtat e shumicës ishin ndryshkur, ishin bërë si statuja e i luteshin statujave, ishin gurë e u faleshin gurëve e qe mbushur dheu me supersticione e besime të kotë. Përfitonte i forti nga injoranca e padija e i shtypte popujt dhe i mposhte shpirtat e mendjet e tyre duke i bërë skllëvër nga pakica; u formuan shtresa që përbuznin njëra-tjetrën.

Por Zoti me mëshirën e Tij, i cili kujdesej për njerëzinë më tepër se nëna për fëmijën e vet, zgjodhi Muhamedin (a.s.) më të mirin e njerëzisë për t’u kumtuar mesazhin e fundit, Kuranin, që t’i shpëtonte nga humnera në të cilën ishin zhytur. Muhamedi qe për njerëzimin si një shi që bie pas një kohe të gjatë thatësire dhe e ngjall dhe i jep jetë Tokës. Mësimet që kumtoi Muhamedi (a.s.) me anën

e Kuranit, qenë një dritë për t’u treguar udhën e drejtë atyre që e kishin humbur nga errësira e madhe që i kish kapluar. Iu ktheu popujve njerëzillëkun e nderin, se që kur filluan të adhurojnë një Zot, krijuesin e tyre, në vend të gurëve e drunjtë, që ia bënë shokë Atij, iu pastruan shpirtat iu ndriçuan mendjet e iu shkëlqyen shpirtat, u çliruan mendjet nga prangat e poshtërimin, nga të fortët e i këputën e i thyen prangat e skllavërisë dhe u bënë të lirë, e filloi të nderohej njeriu jo pse ishte i fortë, ose vinte nga një familje e mirë, ishte i pasur ose kishte këtë apo atë ngjyrë, por ishte me të vërtetë njeri ai që i bënte më mirë njerëzimit, ai që kish sjellje të mira, që ai sakrifikonte për hir të fesë e të atdheut, ai që mbronte të drejta, ai që ish i mësuar dhe i mësonte të tjerët. Shkurt, Muhamedi (a.s.) e mësoi njerëzinë sipas mësimëve të Kuranit, se njeriu më i mirë është ai që bënte më mirë njerëzimit.

Në kohën që erdhi Muhamedi (a.s.), bota mund të ndahej në dy kampe, njëri që ishte krejt materialist dhe që nuk mendonte se si e fitonte pasurinë të cilën pastaj e përdorte vetëm për të kënaqur epsheet e tij dhe tjetri, që ishte ndarë krejt nga bota, ishte mbyllur në muret e manastireve dhe që s’donte të dinte çfarë ndodhte jashtë këtyre mureve. Por mësimet që solli Muhamedi (a.s.) i kombinuan të dyja. Këto mësimë lidhën materien me shpirtin me një një që nuk mund të zgjidhen, e bëri secilën të domosdoshme për tjetrën, duke i porositur njerëzit që të punonin për këtë botë, por të mos harronin të përgatiteshin edhe për botën tjetër, prandaj Kurani urdhëron e thotë: “Ju jeni populli më i mirë i nxjerrë nga njerëzit, urdhëroni të mirën e ndaloni të keqen...” (Kurani, 3:110)

Miliona njerëz nga pasuesit e fesë që predikoi Muhamedi (a.s.) në këto ditë hapin fletët e historisë që të studiojnë jetën e tij, jetën e njeriut më të madh të botës.

Qysh në foshnjëri ishte i zhveshur nga veset e liga, ishte i pastër nga çdo e keqe që të njolloj, qysh në rini u titullua nga populli i tij “Emin”-besniku, i drejti. Ai u zgjodh si arbitër për të zgjidhur një problem që mund të shkaktonte gjakderdhje. Ra në kundërshtim populli i tij kur po meremetonin Qaben se kush ta nrinte e vendoste në vendin e vet Gurin e Zi, secili nga paria donte ta bënte atë, pranuan vendimin e Muhamedit (a.s.) kur e vuri në një rrobë prej çdo të pari të kapte në një anë rroben dhe mandej e vuri po vetë në vendin e duhur. Kështu që me veprën e tij kënaqi të gjithë kryetarët e fiseve. Kjo ngjarje sikur e një paralajmërim se ai do të kumtonte mesazhin e fundit hyjnor dhe do të pastronte Qaben nga idhujt, duke e kthyer atë në një tempull ku lutej vetëm një Zot, të njëjtin Zot për të cilin e kishte ndërtuar atë Ibrahim (a.s.) me të birin Ismailin.

Kur Muhamedi u afrua në dyzet vjetët e jetës së tij shkante në një shpellë ku lutej e meditonte, duke u larguar nga idhujt të cilëve i falej populli i tij, dhe i lutej Zotit natë-ditë që ta udhëhiqte në rrugë të mbarë në fenë e Ibrahimit. Në moshën dyzetvjeçare, në shpellën hira ku meditonte,

zbriti Xhibrili, i cili i komunikoi se Zoti e kishte zgjedhur Pejgamber dhe fillo it'i kumtoj pjesët e para të Kuranit, librin e shenjtë tonin, i cili kritikonte adhurimin e idhujve dhe i ftonte njerëzit që t'i luteshin vetëm një Zoti, Krijuesit të gjithësisë. Ftoi njerëzinë në këto mësimet të reja pa patur të tjerë përkrahës veç Zotit; u përpoq, vuajti dhe u mundua, luftoi me vullnet të hekurt pa u mërzitur nga mundimet e pengesat që i nxirrnin idhujtarët derisa në fund fitoi.

Muhamedi në jetën e tij ishte shembull i shkëlqyeshëm idealisti në fjalë e në vepra, në shtëpi dhe me popullin, në paqe e në luftë. Ishte sikur e cilëson Imam Aliu: "Më dorëhapuri i njerëzisë, më zemërimi, më i drejti në fjalë, dhe më i besuari; kushdo që e shihte ndiente respekt për të, kush merrej me të e dashuronte.

Muhamedi (a.s.) ishte shumë i dashur, kujdesej tepër për shokët e tij, kur mungonte ndonjë prej tyre pyste për të. Gruaja e tij, Aisheja, na tregon për të: "Kur ishte në shtëpi, ishte njeriu më i butë e më i ëmbël."

Pejgamberi (a.s.) ishte shumë i përvuajtur e urrente madhështinë e mburrjen nuk i vinte shumë rëndësi gjërave të kësaj bote. Megjithatë e mbante veten shumë pastër, krihej e i mbante mirë flokët dhe lyhej me erëra të mira. Salltanete nuk donte. Shumë mbretër, princër, e të parë i dërgonin dhurata të çmuara, por ai nuk i mbante për vete, i shiste dhe të holat i përdorte për të ndihmuar të vobektit ose për t'i shërbyer fesë islame. kurrë nuk e mbushte plot stomakun, asnjëherë nuk kërkoi nga familja e tij t'i përgatitej një ushqim i posaçëm, hante çfarë t'i vihej përpara dhe pinte çfarë i jepej nga pijet e lejueshme.

Ai ishte më bujar se retë që derdhnin shi, ndihmonte nevojtarin dhe përkrahte të vobektin, ushqente të uriturin e vishte të zhveshurin. Kurrë nuk i tha njeriu që i kërkonte ndihmë "Jo", e nuk iu shmang asnjëherë nevojave të të tjerëve e kur s'kishte çfarë t'u jepte i përcillte me fjalë ë mira e priste derisa t'i jepte Zoti diçka që t'i ndihmonte. Kaq bujar qe me njerëzit e vobektë saqë njëherë e bija e tij, Fatimja shkoi e iu ankua për punët e shumta që kishte në shtëpi dhe i kërkoi t'i gjente një shërbëtoare. Ai i tha: "Unën nuk mund të të jap ty shërbëtoare e t'i lë banorët e Sufas të mbajnë barkun me dorë nga uria". Sofa ishte vendi ngjitur me xhaminë ku banonin shokët e varfër të Pejgamberit (a.s.) kalonin kohën me studime; Muhamedi (a.s.) kujdesej për mbajtjen e tyre.

Muhamedi (a.s.) ishte tepër trim e guximtar, luftonte burrisht për mbrojtjen e lirisë, fesë e të atdheut; shihej përherë në mes të betejave. Imam Aliu tregon: "Kur ndizej lufta vërenim se Pejgamberi gjendej më afër armikut se askush tjetër."

Kur dilte fitues ndër beteja nuk i rritej mendja e nuk mburrej, dhe kur ndonjëherë ndodhte e kundërta nuk e priste shpresën dhe nuk dëshpërohej, por studionte shkaqet e dështimit dhe mendohej të ndreqte gabimet. Dhe në të dy rastet falënderonte Zotin e i lutej për ndihmë.

Triumfoi e çliroi Mekën nga idhujtarët që e kishin munduar atë si dhe shokët e tij që e kishin brë të vuante aq shumë duke e detyruar të linte dhe vendlindjen e tij prej persekutimeve të mëdha që i bënin, por ku i kishte në dorë e kishte fuqi t'i dënonte, i fali dhe i ndjeu duke u thënë: "Shkoni se jeni të lirë!"

Kërkuan shokët e tij nga Muhamedi (a.s.) që t'i mallkonte idhujtarët pas betejës së Uhudit, në të cilën ishte i plagosur nofulla e i kullonte gjaku rrëke, por ai u përgjigj se nuk e kishte dërguar Zoti për të mallkuar, por për të mëshiruar dhe u lut: "O Zot, fale popullin tim se ata nuk dinë."

Sot në muajin e ditëlindjes së Pejgamberit Muhamed (a.s.) po mjaftohem me kaq sa të paraqes shkurtimisht jetën e tij të shkëlqyer, që ta marrim se shembull në mbrojtje të fesë e të atdheut, në përkrahje të së vërtetës e të së drejtës, në ftesën për të bërë të mira dhe për largimin nga të ligat. Zoti me madhërinë e vet urdhëron e thotë në Kuran: "Ju me të vërtetë keni shembull të shkëlqyer në të dërguarin e Zotit..." (Kurani, 33:21)

Zoti na bëftë prej atyre që e studiojnë me kujdes jetën e Pejgamberit (a.s.) e përpiqen ta marrin shembull në jetën e tyre.

Hafiz Ibrahim Dalliu Poezi për më të shndritëshmin e njerëzimit, Profetin tonë Muhamedin (alejhi selam)

Ti je shembull' i gjithë mirësivët
Ti je ma i ndershmi i nebi vet
Si elmasi n' varg t' inxhivët
N' doresh ja Resulell-llah!

Ti je Diell' i ditunies,
Ja ke ndricue syte njerzies
Je i dashm' i Perendies
N' doresh ja Resulell-llah!

Njaj Zot qi kreu qiell e dhe
N' jetet t' ate ka ba be
Ne ket grade kurkush ma s' le
N' doresh ja Resulell-llah!

N' rruzllit t' dheut ane e m' ane
Ne cdo cast thirret ezane
Ty Resulull-llah tu t' thane
N' doresh ja Resulell-llah!

Per, Ty asht krijue gjithsjaja
Ç' pare bajnë lavdat e mija
Ty t'ka lavdue vete Perendija
N' doresh ja Resulell-llah!

Redaksia

Kreu “Ja-Sin” përmbajtja dhe vlerat



Mekase, 83 ajete

Me Emrin e Zotit Bamirës, Mëshirëplotë.

Në muajin e bekuar të Ramazanit, vëmendja e besimtarit kthehet te leximi i Kur'anit, në mënyrë të tillë që agjërimi i tij të jetë më afër Zotit, këshillave, urdhrave dhe porosive që Ai na jep në Librin e Shenjtë. Nëse agjërimi, me të përmbajturit nga të ngrënit, të pirët dhe kufizimet e tjera, është një sakrificë trupore, Kur'ani, namazi, lutjet dhe lavdet për Zotin janë motivi shpirtëror i agjëruarit, miraxhi i tij drejt Zotit. Sepse, i Madhi Zot është i Gjithëfuqishëm e Pushtetplotë dhe nuk ka mangësi për ta plotësuar me sakrificën tonë. Përkundrazi, ne kemi nevojë që, me mëshirën e Tij, sakrificat jonë të na zëvendësojë mangësitë dhe forcojë besimin. Është kjo arsyeja që gjithsecili ndjen në Ramazan një kënaqësi dhe sukses shpirtëror që nuk mund t'ia arrijë kohët e tjera.

Në fjalorin islam, sure "Jasin" quhet: "Jasin'i Sherif " që do të thotë: Jasin-i i nderuar". Ndërsa Kur'ani cilësohet: "Kur'an'i Kerim" që, gjithashtu, merr kuptimin: i nderuar ose fisnik. Porse, Kur'ani quhet edhe "mexhid" që do të thotë: fisnik, i lavdishëm.

Profeti a.s. ka thënë se "Jasin-i është zemra e Kur'anit." Siç dihet, Fatiha'ja quhet: "Ummul' Kur'an" (Baza e Kur'anit) sepse shpreh në esencë idenë e tij, kurse kreu Jasin përmbledh Kur'anin në tre shtyllat e akaidit (besimit): teuhidin (besimin në një Zot), dërgesën profetike dhe ahiretin (ringjalljen, gjykimin dhe jetën e përtejme) dhe trajton një numër çështjesh të tjera me tematikë dhe shembuj të shumtë. Jasin-i praktikohet më së shumti në kujtim të të vdekurve dhe si këndim Kur'ani për ta. Komentuesit përmendin thënie të Profetit a.s. për t'ua lexuar atyre që janë duke vdekur që t'u vijë më lehtë kalimi nga kjo jetë, ose për të vdekurit. Nga kjo anë, leximi i Jasin-it ka mbetur si ritual, në një ceremoni përkujtimore që mbahet në shtëpi, lokal apo xhami duke zëvendësuar leximin e plotë të Kur'anit ose para lutjes (duasë) së hatmes.

Në këtë kontekst, po citoj një thënie të Imam Gazaliut, sipas të cilit: "Qëndrueshmëria e besimit mbështetet në njohjen e ringjalljes dhe të gjykimimit".

Kreu Jasin u takon shpalljeve të periudhës së Mekës, aty nga mesi ose më vonë, siç vë në dukje Meududi, nisur nga tematika më e gjerë e saj, krahas çështjeve të besimit. Në rendin kur'anor, vjen pas sures Fatir (Krijuesi), që i kushtohet Madhështisë dhe Pushtetit të Zotit dhe para sures Es-Saffat, që trajton ringjalljen. Në rendin kronologjik, Jasin-i është e dyzetë e njëta, jo larg rendit kur'anor, krahas sureve me tematikë të ngjashme. Si shpallje e periudhës së Mekës, kjo sure nuk ka ndonjë ndryshim nga të tjerat në përmbajtje, porse, nga tematika e saj dhe bukuria e gjuhës, Profeti a.s. e ka vlerësuar duke thënë se "do të dëshiroja që Jasin-i të jetë në zemrën e çdo besimtari".

Quhet "Ja-Sin" nga dy shkronjat e alfabetit arab, me tingujt j dhe s (e butë), simbole me të cilat fillojnë disa sure. Sipas Ibn Abbasit, bartin kuptimin: "O njeri" dhe se i Madhi Zot i drejtohet me to të Dërguarit të Tij, Muhamedit a.s..

Já-sin. / Uel' kur'ánil' hakím. / Inneke leminel' murselín. / Alá sirátin mustekím. / Tenzílel' ázízir-rahím. (Ja, sin. / Për Kur'anin e Urtë, / ti je ndër të dërguarit / në udhë të drejtë! / Mesazhi të Plotfuqishmit, Mëshirëplotit. /1-5/)

Pas dy shkronjave në ajetin e parë, Zoti betohet në Kur'anin plot urtësi e gjykim se Muhamedi është ndër të dërguarit në udhën e drejtë e cila përmendet dhe përcaktohet qartë në ajetin 6 të kreut Fatiha. "Sirat(un) mustekim" është përkufizimi i "rrugës së drejtë" në Kur'an, pa devijime. Këtë e shohim, gjithashtu, në ajetet 52-53 të kreut 42, Këshillimi: "Kështu, frymëzuam drejt teje një shpirt me Urdhrin Tonë. Ti nuk e dije ç'janë libri dhe besimi, por Ne e bëmë atë dritë; drejtojmë me të kë duam ndër robtë Tanë dhe ti po udhëheq në udhë të drejtë, udhës së Zotit të Cilit i përkasin ç'janë në qiej e në tokë. Te Zoti përfundojnë çështjet."

Përgjatë Kur'anit, kryesisht te suret e periudhës së Mekës që kanë ton poetik, me pjesëzën "ue", e cila shërben si lidhëse mes fjalëve e fjalive, në të shprehurit metaforik, bëhet një lloj betimi për t'i dhënë theksin e duhur subjektit më pas. Zoti xh.sh. betohet në krijimin dhe dukuritë e Tij, siç betohet, për shembull: për diellin, hënën, ditën, natën, kohën etj. Betimi në to është i figurshëm dhe përdoret si mjet letrar. Betimi te Kur'ani përsëritet në suret 38:1 dhe 50:1.

Ajetet 6-10 u drejtohen mohuesve mekas të cilëve nuk u pati ardhur profet sikurse bijve të Izraelit dhe patën mbetur të çoroditur mes monoteizmit që nga koha e Ibrahimit dhe Ismailit a.s. dhe idhujtarisë më primitive. Kur u erdhi, mes tyre, i Dërguari i Zotit, Muhamedi a.s., me libër e sqarim, sikurse judenjve Musai a.s., ndërsa e prisnin, nuk e besuan dhe u treguan mendjemëdhenj e kryeneçë, si të kishin në qafë dhe në mjekër hallka që i mbanin kryepërpjetë (shih ajetin 8). Kur lexon Kur'anin nga fillimi i sures së dytë, Bekare (Lopa), të periudhës së Medines, vëren po atë qëndrim të mohuesve.

Ajeti 11veçon njerëzit që marrin këshillë, ata që ndjekin Kujtesën (arab. dhikr, Kur'anin) dhe i frikësohen Zotit Bamirës e Mëshirëplotë (arab. Err-Rrahman) në të padukshmen. Arabët besonin Zotin - Rrahman (Mëshirues i përgjithshëm), trashëguar nga besimi monoteist i Ibrahimit a.s., por adhuronin idhujt e familjes dhe të farefisit, ndërsa besimi i tyre nuk ndikonte aspak në besëtytnitë dhe jetën barbare që bënin. Ishte kjo arsyeja që ata refuzuan misionin profetik të Muhamedit a.s.. Atyre që besuan dhe ndoqën Kujtesën, Zoti u jep sihariq për falje dhe shpërblim bujar (ajeti 11).

"In-ná nahnu nuhjl' meutá ue nektubu ma kad-demú ue áthárehum ue kul-le shej-jin ahsajnáhu fí imámin mubín." kNe ngjallim të vdekurit dhe shkruajmë çfarë përgatitën edhe gjurmët e tyre. Gjithçka e numërojmë në evidencë të qartë." (Ajeti 12)

Me fjalët e para: "Inna nahnu..." (Me të vërtetë, Ne...), i Madhi Zot tërheq vëmendjen e mohuesve për ringjalljen dhe pasqyrimin e veprave të tyre në evidencë të qartë. Komentuesit e shpjegojnë këtë ajet në kuptimin që, jo vetëm me regjistrimin

e veprave, por edhe me pasojat e tyre. Gjithashtu, me gjurmët që lënë lëvizjet e trupave në hapësirë, këtu, në regjistrin e veprave. Sikurse thuhet në ajetin 65 dhe në disa sure të tjera: "Sot ua zëmë gojën; na flasin duart e tyre dhe u dëshmojnë këmbët për çka fituan." Në ditët tona, ky është një realitet i aplikuar në elektronikë.

"Jepu shembull banorët e qytezës kur u erdhën të dërguarit..." Në ajetet 13-29 jepet një episod me të dërguarit pranë një vendbanimi. Disa komentues e lidhin me Antiokinë sipas gojëdhënave biblike. Zoti, në Kur'an, bie shembuj si mësim për brezat. Te kreu 18, Shpella, ajetet 22-26, kur diskutohet për numrin e të rinjve besimtarë që u mbyllën në shpellë dhe kohën e qëndrimit të tyre, Zoti xh.sh. i thotë Muhamedit a.s.: "Thuaj: "Zoti im e di numrin e tyre. Pak dinë për ta. Diskuto rreth tyre në dukje dhe mos kërko tek ata ndonjë vendim." ... "Thuaj: "Zoti e di sa qëndruan. Atij i takon e panjohura e qiejve dhe e tokës..."

Krahas të dërguarve që populli i përgënjeshtroi e mohoi, duke i akuzuar se me ta ka "ogur të keq", del edhe një njeri nga populli që i këshillon bashkëkombësit t'i dëgjojnë dhe pasojnë të dërguarit, siç ka ndodhur kurdoherë ndër popujt, porse ata s'e dëgjuan ndërsa atij iu tha: "Hyj në parajsé!..." Me këtë, kuptojmë se parajsa dhe skëterra janë relative në kohë dhe hapësirë.

"Oguri i keq" i të dërguarve të Zotit dhe njerëzve që ndalojnë të keqen e këshillojnë të mirën në shoqëritë që nuk besojnë Zot e ringjallje, trajtohet disa herë në Kur'an. Kjo ka ndodhur e ndodh edhe në shoqërinë tonë ku njerëzit e pafe, mes tyre, shumë intelektualë, nuk arrijnë të kuptojnë se ku katandiset një shoqëri pa Zot.

Pas ajeteve 28-32 që tregojnë se si



përfunduan breznitë e kaluara, jepen shembuj analogë nga natyra e gjithësia dhe nga vetja jonë. Ndër ta, lëvizja e diellit dhe e hënës në orbitat e tyre ishte një koncept i ri, më i avancuar nga ai i Ptolemeut ndërkohë që banorët e shkretëtirës së Arabisë nuk kishin njohuri për të.

“Edhe dielli lëviz në ciklin e vet. Ky është përcaktimi i të Plotfuqishmit, Dijeploitit. / Hënës i caktuam faza derisa kthehet e bëhet si degë e vjetër palme. / Dielli s’ia arrin hënës, as nata parakalon ditën. Secili noton në orbitë.” (Ajetet 38-40)

Në kontekstin e sures, trupat qiellorë i nënshtrohen rendit të përgjithshëm. Nga pikëpamja e fizikës së trupave, parimi kur’anor është dinamika. Në kreun 27, ajeti 88, thuhet: “Sheh malet dhe i pandeh se nuk lëvizin, por kalojnë si retë. Është arti i Zotit, i përsosur në çdo gjë...”

Fahrudin Al Razi (1149-1209), tre shekuj para Kopernikut, krahas shpjegimit të gjerë të Kur’anit, trajtoi teorinë e lëvizjes së tokës, diellit dhe të sistemeve yjorë në hapësirë.

Zoti thotë në Kur’an: “Ndër dëshmitë e Tij është krijimi i qiejve e i tokës dhe gjallesave që ka përhapur në to, që, në dashtë, ka fuqi t’i bashkojë.” (42:29)

Ftesa e profetëve lidhet me të tashmen dhe të ardhmen që njerëzit të përgatiten me veprat e tyre (ajetet 45-46). Mirëpo ata janë indiferentë ndaj dëshmive të Zotit. Edhe kur u thuhet të kontribuojnë për të varfrit me ç’u ka dhënë Zoti, tërhiqen dhe thonë: “...Të ushqejmë dikë që, po të deshte Zoti, e kishte ushqyer?...” (ajeti 47). Ky kontribut bamirësie u bë detyrim zekati për besimtarët gjatë periudhës së Medines.

Pas ajetit 12 që tërheq vëmendjen për ringjalljen, prej ajetit 48 e në vazhdim, përshkruhet ngritja nga varret dhe shpërblimi me parajsë e skëterrë. “Dalja

nga varret” është një aspekt i figurshëm i panoramës së ringjalljes. Kur’ani flet shumë për këtë, siç thuhet në ajetin 68: “Kujt i japim jetë, e kthejmë në krijim. A nuk kuptojnë?” Përkundër mesazhit profetik, mekasit thoshin se Muhamedi është poet. Ata e njihnin fare mirë pasi që rritur mes tyre. I Madhi Zot thotë: “S’ia mësuam atij poezinë dhe nuk i shkron. Kjo është kujtesë dhe një këndim i qartë, / të paralajmërojë kë është i gjallë. Mohuesve u është përligjur fjala.” (Ajetet 69-70)

Mohuesit nuk besojnë në ringjallje pasi ata nuk besojnë krijimin e tyre të cilin e shohin të paqëllimtë ... Zoti thotë në ajetet e fundit të sures Jasin:

“Nuk sheh njeriu që e krijuam nga një pikë? Kur, ja, ai del kundërshtar i hapur. / Na bën krahasim dhe harron krijimin e tij. Thotë: “Kush i ngjall eshtrat kur të jenë kalbur?” / Thuaj: “I ngjall Ai që i ngrii herën e parë. Për çdo krijim Ai është i plotditur.” / Që bëri për ju nga druri i gjelbër zjarr dhe, ja, prej tij digjni. / Ai që krijoi qiejt e tokën, nuk ka fuqi si ato të krijojë? Po, Ai është Krijuesi i Madh, Dijeploit. / Kur do diçka, urdhëron e i thotë: “Ji (bëhu)!” – dhe ajo është (bëhet). / Madhëruar qoftë Ai në Dorën e të Cilit është sundimi i çdo gjëje dhe që tek Ai ktheheni!” (Ajetet 77-83).

Ebu Hurejra, ndër mbledhësit më të njohur të hadithit, na përcjell porosinë e të Dërguarit të Allahut, Muhamedit a.s., i cili ka thënë: “Kush lexon Jasin-in natën, ngrihet në mëngjes i falur...”

Në një hadith tjetër, Profeti a.s. ka thënë: “Kush lexon Jasin natën, për kënaqësinë e Zotit të Plotfuqishëm e Lavdiplotë, është i falur.”

K. S. Hoxha



Humanizmi i **Profetit Muhmed (a.s.)**



Në të vërtetë, lindja e këtij njeriu madhështor ishte shpëtim për mbarë njerëzimin, për sa i përket besimit, adhurimit, moralit, drejtësisë, thjeshtësisë, etj. Këtë njeri e zgjodhi vetë Krijuesi i gjithësisë me dëshirën e Tij absolute, sipas parametrave hyjnorë dhe jo atyre njerëzorë. Muhamedi, i biri i Allahut (paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të), duke qenë vula e mbarë të Dërguarve dhe Pejgamberëve, shndriti gjithë rruzullin tokësor me shembullin e tij konkret në të gjitha aspektet e kësaj jete materiale.

Ai zotëri, jo vetëm që është nderuar, respektuar dhe rruga e tij profetike është ndjekur nga myslimanët në përgjithësi, por, siç dihet realisht, ai nderohet e vlerësohet edhe nga ithtarë të besimeve të ndryshme, të cilët i japin merita për të gjitha çështjet dhe respektohet me nderim nga dijetarë e shkencëtarë të mëdhenj, nga politikanë e filozofë të shquar, nga akademikë e letrarë të njohur të botës.

Në arabinë e asaj kohe, në Romën Lindore e në Iran, njeriu ishte ose një krijesë e egër, dhunuese, e trashë dhe e pamëshirshme, ose një qenie e robëruar, e dhunuar dhe e mjerë. Profeti Muhamed (a.s.) gjeti para vetes sundimtarë që krijesat e Zotit i kishin bërë shërbëtorë dhe skllëvër, pa gëzuar asnjë të drejtë njerëzore. Ai erdhi në një kohë kur morali kishte rënë përtokë, luftërat dhe konfliktet ishin përhapur tej mase, i fort mundte të dobëtin, i pasuri shfrytëzonte të varfrin, pra me një fjalë nuk ekzistonte asgjë njerëzore dhe asnjë ndjenjë shpirtërore. Hz. Muhamedi (a.s.) i qe dërguar profet një turme njerëzore, që, copën e drurit të sjellë nga mali, e gdhendte dhe e adhuronte si "Zot", që, pasi e gatante hallvën me duart e veta dhe i jepte formë, e kthente në statujë dhe i përullej, pastaj kthehej dhe e hante kur të urrete. Ky profet, i cili u dërgua te një grup njerëzish që e groposnin vajzën të gjallë dhe nga ky veprim nuk ndjenin hidhërim e turp, por ngazëllim e krenari, nxori në shesh një komb të tillë, individët e të cilit u bënë model i gjallë i mëshirës e i delikatesës! Ai nxori nga çobanët e deveve, zotërinjtë e njerëzimit.

Ai ishte njeriu i paqes e i qetësisë. Ne e dimë dhe e besojmë kategorikisht se mesazhi që ai solli, ishte gjithashtu një burim paqeje e qetësie dhe për këtë, historia është dëshmitarja më e madhe. Ja pra, e vetmja zgjidhje për ta bërë njerëzimin që ta shijojë përsëri këtë paqe e qetësi, është që t'ua bëjmë të njohur njerëzve atë dhe dritën që solli ai, sepse në raport me sa do të njihet ai dhe në sajë të asaj dashurie, do të ndërrojë fytyra e shoqërisë.

Po të kishte dashur, ai mund të bëhej njeriu më i pasur i botës. A nuk ia patën propozuar këtë Kurejshët qysh në ditët e para të shpalljes së profetësisë së tij me kusht që të hiqte dorë prej çështjes së vet?! Edhe më pas, gjërat që jepnin myslimanët në rrugën e Allahut, të gjitha nëpër duart e tij kalonin. Dhuratat e ardhura prej sundimtarëve nuk kishin të llogaritur. Mirëpo ai kurrë nuk mori prej tyre ndonjë gjë për vete, madje as nuk i pati shkuar ndërmend një gjë e tillë!

Në qe kështu, atëherë duhej ta preokuponte zemrën me gjërat specifike që me të vërtetë u duhej dhënë rëndësi. Gjithashtu duhej t'u mësonte njerëzve rrugët që çonin tek të qenët njeri. Afrimi te Zoti ishte qëllimi i tij parësor dhe detyra për t'i çuar njerëzit tek i njëjti objektivi. Ja, për këtë vuante e digjej ai! E ç'rëndësi mund të kishte pasuria e kësaj bote për një njeri në një pozicion të tillë?! Sigurisht, asnjë rëndësi. Atëherë, s'ia vlente të sakrifikohesh për të...

Dërgimi i Muhamedit (a.s.) është mëshirë nga Allahu, që njerëzit t'i zgjidhin problemet e tyre në mënyrën më të drejtë e më humane, sepse Ai që na krijoi më së miri i di nevojat e krijesave, prandaj përmes Kuranit ofron udhëzime afatgjatë dhe të përsosur. Kush dëshiron nga ky shembull i humanizmit, le të mobilizohet dhe le të aktivizojë karakterin e vet njerëzor. Kjo do ta ndihmojë që të kuptojë dhe të bëhet qenie humane sipas shembullit të Muhamedit (a.s.) dhe vëllezërve të tij, pejgamberëve të tjerë.

Dorian Demetja

Kur'ani është ilaç

Shifa, është një fjalë arabe dhe do të thotë "trajtimi dhe shërimi i një sëmundjeje". Kjo fjalë do të thotë gjithashtu në mënyrë metaforike "shërimi i sëmundjes së injorancës, arritja e paqes dhe rehatisë".¹

Fjala Hijnore, duke na shpjeguar vetveten, urdhëron se ka shërim në të. Por, si mund ta kuptojmë këtë?

Konceptin e "shifas/shërimit" e hasim në gjashtë vende në Kur'anin e Shenjtë.² Kur shikojmë ajetet para dhe pas ku përmendet fjala, shohim se kuptimi i saj i shërimit dhe trajtimit del në pah në dy vende dhe kuptimi i zgjidhjes së problemeve del në pah në katër vende.

Menjanimi i telasheve në botë dhe vendosja e paqes, paqja e vërtetë e njerëzimit, njohja e Allahut dhe e marrëdhënieve ndërmjet tre udhërrëfyesve universal, të universit, Pejgamberit (a.s) dhe Kur'ani deri në thellësitë më të vogla, varet nga njohja e drejtë e Librit të fundit të Shejtë.

Allahu permes ajetit: "Ne të shpallim Kur'anin që është shërim për besimtarët." (Isra, 17/82), na thotë se ne mund të gjejmë një zgjidhje për të gjitha problemet dhe të hapim çdo derë me këtë burim shërimi. Përderisa çështjet zgjidhen sipas kohës dhe hapsirës, atëherë mjafton ta kuptojmë atë sipas këtyre rrethanave.

Ndërsa Furkani i Gjithurti na shpjegon veten, ai na shpall se disa ajete janë muhkem, pra janë të qarta, dhe disa ajete janë muteshbih, pra kuptimet e tyre janë të fshehura. Ai shpjegon se Allahu i di domethëniet thelbësore të ajeteve muteshbih dhe se Ai i informoi ato përmes shpalljes tek pejgamberet zemrat e të cilëve ishin të pjekura dhe tek trashëgimtarët e pejgambereve përmes frymëzimit. Ne mund t'i mësojmë ato koncepte të paqarta nga veprat e atyre personaliteteve me zemër

1. Firuzabadi, Kamus Tercümesi, rrënja foljore "SHFJ"; RAglb el-Isfahani, Müfredat, rrënja foljore "SH-F-V".

2. Et-Tevbe 9/14, Junus 10/57, En-Nahl 16/69, Isra 17/82, Shuara 26/80, Fussilet 41/44.

të gjallë, përndryshe nuk mund ta kuptojmë plotësisht frymën e koncepteve të paqarta me kuptimin tonë. Përpjekja për të zotëruar këtë frymë do të rezultojë që Fjala Hijnore të jetë ilaçi për problemet tona.

Këto të vërteta janë si ilaç për brezat e sotëm të dërrmuar. Është një kurë e plotë për çdo çështje, nga parimet morale dhe tregtare e deri te marrëdhëniet ndërkombëtare. Përderisa dimë ta lexojmë dhe kuptojmë kuptimin e saktë.

Ky thesar, burimi i dhikrit, i mendimit dhe i mirënjohjes, është ilaçi për të gjitha sëmundjet shpirtërore, pengesa më e rëndësishme që mbron njerëzimin nga injoranca dhe eliminon të gjitha dyshimet.

Kur'ani thotë: "Mosiu afroni tradhtisë bashkëshortore!" (Isra, 17/32), dhe këtu shpreh një kuptim të veçantë. Ai shpjegon parimet e borgjit (Bekare, 2/282); këtu shpreh një kuptim tjetër. Kur i lexojmë saktë këta shembuj me ajetet ndërlidhëse dhe i zbatojmë në jetën tonë, me lejen e Allahut, Kur'ani do të na shërojë plagët. Ne do të jemi të varur nga kërkimi i zgjidhjeve në të.

Nëse përpiqemi t'i shqyrtojmë këto ajete sipas renditjes në Mus'haf:

"Allahu i shëron zemrat e njerëzve besimtarë!" (Et-Tevbe, 9/14). Kuptimi në këtë ajet është që zemrat të ndihen të lehtësuara dhe të qeta.

"O ju njerëz! Juve ju erdhi nga zoti juaj këshilla (Kur'ani) dhe shërimi i asaj që gjendet në krahorrët tuaj (në zemra), edhe udhëzim e mëshirë për besimtarët." (Junus, 10/57) Këtu thuhet se ka trajtim për shqetësimet në zemër. Nga ky ajet mund të kuptohet se kjo është psikoterapia që përdoret sot për problemet tona të zemrës.

"... Nga barku i tyre (bletëve) del sherbet (mjaltë) me ngjyra të ndryshme, në të cilin ka shërim për njerëzit..." (En-Nahl 16/69). Në këtë ajet, efekti shërues i mjaltit, mund të thuhet se u përdorë në kuptimin e tij origjinal të fjalës shërim.



"Ne zbritëm nga Kurani diçka që është shërim dhe mëshirë për besimtarët..." (Isra, 17/82). Theksohet se ajo që është shpallur është shërim dhe mëshirë.

"Ai është ai që më shëron kur jam i sëmurë". (Shuara, 26/80). Në këtë ajet, ku shërimi përdoret në kuptimin e tij origjinal, janë fjalët e Pejgamberit Ibrahim (a.s).

"... Thuaj: Ai është udhërrëfyes dhe shërim për ata që besuan..." (Fussilet, 41/44). Në këtë ajet shpjegohet se ai është ilaç për të gjitha problemet tona dhe se nëse e përdorim siç duhet këtë udhëzues, ai do të na shërojë.

Ekziston një thënie në librat e hadithit që i atribuohet Abdullah ibn Abbasit (r.a). Ky personalitet i madh, për të cilin Pejgamberi ishte lutur, "O Allah, mësoje atij Librin dhe bëje të aftë në fel"³, duke komentuar ajetin, "Nuk ka asgjë që nuk gjendet në një libër të qartë." (En'am, 6/59) thotë se edhe "nëse i humb frerët e devesë sime, do t'i gjeja me Kur'an"⁴. Abdullah ibn Abbasi, i cili ishte piktoruar/edukuar me bojën e shenjtë të Pejgamberit që në moshë të re, mund të tregojë frerët e devesë së tij edhe në zgjatimin e shkronjës mim të atij libri, që është interpretimi i universit; por kryesorja është se ky kuptim është metaforik, dhe si ai dëshiron të na thotë se ne mund të gjejmë gjithçka në Thesarin e Shenjtë të Allahut si zgjidhje.

Në Revelacionin Hyjnor ka gjithçka, drejtpërdrejt dhe tërthorazi; ata që e lexojnë mund të marrin atë që duhet të marrin sipas aftësisë së tyre për të kuptuar. Secili interpretues kuptoi gjëra të ndryshme sipas shkallës së vet të kuptimit. Duke u marr me implikimet e tyre disa i interpretonin ato si kuptime të qarta, ndërsa të tjerët i interpretonin si shenja dhe simbole.

Një tjetër kuptim i fjalës shifa në Kur'an është; shërim për sëmundjet e injorancës, mohimit, politeizmit, përçarjes, dyshimit dhe mëkatit. Pavarësisht se nga cili këndvështrim shkencor do ta shikojmë, mund të

3. Buhariu, 'Ilm, 17; Vudu', 10.

4. Sujuti, Itkan, 4/31.

gjejmë një të dhënë për shërimin e përkthyesit dhe udhërrëfyesit të shekujve. Ndërsa nga këndvështrimi i një sociologu është një recetë për shpëtimin e shoqërisë, nga këndvështrimi i një psikologu është një recetë për shpëtimin e jetës dhe mendjes individuale, dhe mbetet udhërrëfyesi më i rëndësishëm. Kur'ani është shërim për të gjitha sëmundjet individuale dhe shoqërore. Është një kurë për dyshimet, një udhërrëfyes që sjell harmoni në sjellje dhe një pengesë shpirtërore që mbron nga besimet e korruptuara dhe zakonet e këqija.

Lakimi/Zgjedhimi është emri i metodës për të thënë vazhdimisht gjërat, por duke ruajtur origjinalitetin e tyre. Stili i lakimit të Kur'anit është; diskutimi dhe shpjegimi i të vërtetave dhe urdrave sublime nga këndvështrime të ndryshme duke përdorur mjete të ndryshme. Kur shikojmë ajetet ku përmendet fjala, shifa përmendet si shërim për zemrat në një vend, si mëshirë në një vend tjetër dhe si udhërrëfyes në një vend tjetër. Nuancat e ndryshme të një fjale dhe koncepti shpjegohen nga këndvështrime të ndryshme sipas të kuptuarit të bashkëbiseduesve (lexuesve).

Si një libër i qartë, Kur'ani është burimi më i rëndësishëm i shërimit për brezat e sotëm në depresion; mjafton që të mund t'i gjejmë ato ilaçe në këtë farmaci të rrallë dhe t'i përdorim për të gjitha problemet tona. Le ta përfundojmë artikullin tonë duke folur për një zakon që kemi dëshmuar te të rriturit: Sa herë që ndihen të mërziur ose ndeshen me një problem që duhet ta zgjidhin, ata i drejtohen Fjalës Hyjnore, hapin një faqe, fjalë për fjalë marrin frymë me ato shenja, marrin parasysh si një lloj shërimi dhe largpamësinë e tyre, ata e përcaktojnë mënyrën e veprimit të tyre sipas mënyrës se si u drejtohet Kur'ani.

Nga turqishtja Haki Sahitaj

Mjek i sëmundjeve morale e shoqërore



Çdo njeri ka nevojë për këshillat e më të diturit, sepse njerëzit nuk kanë të njëjtën shkallë diturie. Për këtë njerëzit përdorin çdo mjet të ligjshëm për të plotësuar si nevojat materiale, ashtu edhe ato shpirtërore. Nevojat e njeriut përbëjnë ligjin e pandryshuar të natyrës.

Në botën tonë asgjë nuk qëndron pa nevojën e një gjëje tjetër, për të siguruar qenien e vet. Yjet në të gjithë sistemin e galaktikës kanë nevojë që të marrin dritë për të ndriçuar. Pemët e lulet kanë nevojë për dhe, dritë dhe ujë. Edhe njerëzit janë të shtrënguar të punojnë gjithnjë e me vullnet për të plotësuar mjetet e ligjshme për të jetuar.

Kështu, për t'u pajisur me virtyte të larta, me dije e kulturë kemi nevojë të përfitojmë prej këshillave të njerëzve të ditur, shkencëtarëve, filozofëve, prijësve fetarë, etj.

Nuk ka dyshim se për t'u zhvilluar mendërisht, për t'u pajisur me dituri dhe për t'u gdhendur shpirtërisht, duhet domosdo të mësojmë nga të diturit.

Çdo sëmundje ka nevojë të mjekohet. Mjekë të sëmundjeve moralo-shoqërore janë të diturit, shkencëtarët, drejtuesit fetarë, që përpiqen me fjalën dhe veprën e tyre të përmirësojnë moralin e popullit që të ngrihet sa më lart shpirtërisht.

Fjalët e një këshilluesi të ditur për shërimin e sëmundjeve shpirtërore, nuk mund të zëvendësohen nga asgjë. Ashtu si shiu i butë përtërin një jetë tjetër më të këndshme, në mënyrë që pemët e lulet zbukurohen e përtërihen, kështu edhe fjala e një predikuesi të përgatitur, me mendim të thellë, studiues e njohës i historisë dhe i filozofisë islame, serioz dhe i prerë në mendime, me reputacion e gojëtar i të veçantë, njohës i gjuhës, mbush me gëzim e fllad shpirtin e njeriut. Ai bën të mundur me temat e zgjedhura, që trajton në predikim, të zgjojë fuqinë mendore të besimtarëve që marrin pjesë, duke ndihmuar në zhdukjen e veseve të këqija dhe në gjurmët e shëmtuara prej shpirtit të tij.

Pa dyshim, predikuesi i përgatitur për çka do të ligjërojë, bën një transformim në shpirt të dëgjuesit, duke mjekuar sëmundjet morale e shpirtërore. Ashtu si mjeku që së pari bën diagnostikimin në trup të të sëmurit e mandej jep receta për barnat e nevojshme, ashtu edhe predikuesi, si këshillues që është, duhet të zbulojë së pari mungesat shpirtërore të trupit të shoqërisë që jeton, mandej merr masa për zhdukjen e këtyre mungesave.

Predikuesi i vërtetë është ai që ka dijeni të plota, është studiues dhe njeh literaturën e nevojshme, ka aftësi të



provokë e të argumentojë atë që thotë, njeh në thellësi nevojat materiale dhe shpirtërore të njerëzve, tërheq dëgjuesit me fjalën e tij sa serioze, aq edhe të ëmbël.

Nuk mund ta gëzojë emrin predikues, ai që lodhet më kot duke tjerë fjalë boshe, duke përhapur mendime e ide pa jetë e vlerë, të huazuara nga libra të ndryshëm, ndoshta edhe me mendime kontradiktore. Disa të tjerë i mburren shkollës që kanë kryer dhe ngelen skllëvër të leximit të thjeshtë nga libra që botohen në gjuhën amtare. I shkreti besimtar! Kemi të bëjmë në këtë rast me persona që mbivlerësojnë veten dhe injorojnë dëgjuesin. A lejohet kjo? Ç'vlerë ka predikimi nga persona të veçantë, që s'kanë mbaruar ende shkollën e mesme, që s'kanë ende dijeni nga historia islame pa e më në dijet filozofike e sociologjike, që nuk njohin gramatikën e sintaksën e gjuhës sonë, që lexojnë një libër të botuar rishtas e ndoshta me përkthim e redaktim që lë për të dëshiruar dhe me egon e tyre (mpleksur këtu edhe fodullëku e një të padituri të llastuar) kërkojnë të predikojnë. Këtyre personave u duhet thënë "Ndall!" nga drejtuesit e këtij institucioni.

Predikuesi është, ndërkohë, edhe mësues i vërtetë. Ashtu si mësuesi i mirë, që përcakton temën e mbi

këtë bazë, lexon librat përkatës për këtë qëllim, edhe predikuesi, që është ligjërues, duhet të përcaktojë temën në përshtatje me vendin dhe kohën e, pasi të njihet me literaturën përkatëse, sipas temës që do të trajtojë, do të mbajë shënimet e nevojshme, të cilat do t'i ballafaqojë me besimtarët.

Predikuesi i mirë, me një shkallë të saktë dijeshe dhe njohjesh, është në gjendje t'i përgjigjet pyetjeve që mund t'i bëhen në çdo takim individual apo të grupuar.

Pra detyra e predikuesit është të ndriçojnë mendjet e besimtarëve, të shpjegojë parimet e sakta të fesë, të japë një edukatë të plotë qytetare e shoqërore.

Sot, më shumë se kurrë, ku, në sajë të influencave dhe ndërhyrjeve nga jashtë, janë përhapur sëmundje morale të ndryshme, detyra e predikuesit bëhet më e vështirë.

Prandaj, predikues nuk mund të jetë kushdo, por ai që këtë emër e meriton dhe që zotëron cilësitë e merituarat të një predikuesi.

Remzi Sh. Gani

Zemra

thelbi i qenies
njerëzore

Njeriu. Një qenie e mistershme dhe me plot enigma. Njohja tërësore e botës së tij materiale dhe thellësive të tij shpirtërore mbetet e pamundur. Shkencat pozitive të cilat kanë si subjekt vetëm përbërjen material të njeriut si biologjia, anatomia, fiziologjia dhe mjekësia kanë arritur sukses të madh këtë epokë ku në njërën anë kanë thelluar njohuritë mbi Adn-në deri në detajet më të hollësishme të saj, në anën tjetër kanë arritur në zbulime marramendëse në teknologjinë e gjeneve. Por, aq sa është njohja mbi përbërjen e qenies së njeriut aq është edhe padituria mbi të. Në çdo zbulim kuptojmë edhe njëherë sa të pakta janë ato që nuk dimë në raport me ato që dimë. Shkenca moderne ka arritur në zbulime të mëdha për sa i përket aspektit material të njeriut. Por, çfarë mund të thotë ajo për botën e tij të brendshme, ndjenjat, mendimet, urrejtjen, zillinë, babëzinë, dëshirën, dhembshurinë, dashurinë dhe mëshirën të cilat nuk janë subjekt i metodave si eksperimentimi dhe vëzhgimi?! Padyshim që gjërat që mund të thotë për një fushë e cila nuk është subjekt i metodave të saj janë të kufizuara. Gjendja e njeriut modern, në një farë mënyrë reflekton edhe suksesin e shkencës së psikologjisë. Bota shpirtërore e njeriut është e mbyllur ndaj psikologjisë dhe filozofisë moderne. Pasi njeriu është një qenie e pakufishme dhe hapur drejt hyjnore dhe pafundësisë, ai nuk mund të përfshihet në të gjitha dimensionet e tij. Vetëm ata të cilët i përkasin asaj bote shpirtërore, kanë arritur mundësinë të hapin krahët drejt pafundësisë në aspektin shpirtëror dhe moral janë të aftë për të prekur fshehtësitë e shpirtit të tij.

Kultura moderne, e cila shpeshherë njeriun e njëson me dimensionin e tij material, pyetjen "Çfarë është njeriu?" e tjetëron në "cili është funksioni i tij?" dhe si rrjedhojë vlera e tij matet vetëm nëpërmjet funksionit të tij në këtë aspekt. Në një shoqëri të tillë, merr vlerë forma mbi thelbin, jashtësia mbi brendësinë, dhe trupi mbi shpirtin e tij. Pasi që njeriu i kushton një kujdes të tepruar paraqitjes së tij trupore, industria e produkteve kozmetikeve është kthyer në një fushë që po zhvillohet me hapa të shpejtë për plotësuar apo nxitur nevojat e tij. Në anë tjetër, në shoqërinë moderne njerëzit të cilët kanë mangësi të caktuara në paraqitjen e tyre fizike apo nuk arrijnë të përshtaten dhe ndryshojnë duke iu përshtatur këtyre rregullave, në vend se të jenë subjekt i dhembshurisë ndjehen të shtypur duke i çuar ata drejt stresit dhe problemeve psikologjike.

Kur trupi i njeriut merr një rëndësi kaq tepruar

në perceptimin tonë, zemra dhe morali mbeten në hije dhe e humbin vlerën e tyre. Kështu filozofi i cili e lidhin qenien me aftësinë e të menduarit duke thënë që "Mendoj, pra ekzistoj", në ditët e sotme do të thoshte "dukem, pra ekzistoj". Kështu vëmendja dhe si rrjedhojë idealet dhe vlerat përcaktohen nga ata që bëjnë një jetë të luksoze, paraqiten në formën më të bukur dhe të tjerët duhet të përqipen për të arritur qëllimeve të tilla. Si rrjedhojë, në një shoqëri të tillë, vlerat si modestia, mjaftueshmëria, durimi dhe bujaria fillojnë të veniten dhe humbin ndikim e tyre.


Në botëkuptimin islam njeriu përkufizohet nëpërmjet zemrës dhe moralit të tij. Nëse do ti referohemi shembujve dhe kulturës islam përgjatë historisë do të shikojmë se mangësitë trupore të një kategorie prej njerëzve, i bënin ata subjekt të dhembshurisë dhe përkujdesjes dhe jo të përjashtimit nga shoqëria. Profeti a.s do të paralajmërohej nga Zoti në një moment kur nuk i kushtoi rëndësinë e duhur një njeriu të verbër që erdhi pranë tij. Sepse vlera e njeriut nuk matej nëpërmjet paraqitjes së jashtme por pastërtisë së zemrës, dhembshurisë, mëshirës dhe sinqeritetit. Ata të cilët arrinin majat në përluljen ndaj Zotit dhe mirësisë që rrezatonin për të tjerët përbënin shembull dhe vlerë për shoqërinë. Duke jetuar me mirësi, drejtësi, mëshirë, sakrificë, sinqeritet, bujari, dashuri dhe përvuajtje ata i jepnin jetë shoqërisë dhe ishin burim i qëndrueshmërisë dhe drejtësisë në të.

Të identifikosh qenien e njeriut me trupin e tij, është sikurse molla të ishte e përbërë vetëm prej lëkurës së saj. Ndërsa njeriu merr vlerë nëpërmjet pjekurisë së tij shpirtërore dhe morale. Me anë të shpirtit dhe zemrës së tij përsoset. Sepse zemra është thelbi i qenies njerëzore. Ajo është një derë e hapur drejt pafundësisë. Profeti a.s na mëson se zemra është si një barometër që përcakton vlerën e njeriut që nëse ajo është mirë, i gjithë trupi dhe qenia e tij do të jetë mirë, e nëse ajo është keq do të reflektohet në që të gjithë qenien e tij. Nëse asnjë produkt dhe shërbim i jashtëm nuk i dhuron qetësinë shpirtërore njeriut, atëherë ai duhet të kujdeset për ta pastruar zemrën e tij nga sëmundjet e saj si zilia, hipokrizia, pangopësia, smira dhe urrejtja. Si një vend i denjë për dashurinë hyjnore ajo duhet ujitur me ndjenjat më të larta për të qenë gjithmonë nën dritën dhe përkujdesjen hyjnore dhe duke rrezatuar plot dritë për botën tonë njerëzore.

Dhe në fund njeriu do të marrë atë që ka mbjellë në zemrën e tij...

Përgatiti: Abdullah Bulku

NGADHËNJIMI I MEKËS



Kur i Dërguari Fisnik (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) u vendos në Merru'dh-Dhahran, Abasi (radijallahu anhu) i tha:

- "Mjerë për kurejshët! Uallahi, nëse i Dërguari i Allahut do të hyjë në Mekë me forcë, pa i kërkuar njëherë kurejshët të falur, atëherë ta dini se për kurejshët nuk ka më shpëtim!"

Pastaj vazhdoi të thoshte: - "Hipa në mushkën e bardhë të të Dërguarit të Allahut dhe duke dalë nga radhët e ushtrisë, mbi shpinën e saj, arrita në zonën e Erakut. Thashë mos takohem me ndonjë që ka dalë për drurë, ndonjë çoban, apo ndonjë që ka dalë për ndonjë punë tjetër të tijën dhe i them; ai shkon dhe lajmëron mekasit se ku ndodhet i Dërguari i Allahut dhe ata vijnë që t'i kërkojnë të falur; kështu, i Dërguari i Allahut nuk do të ndihet i detyruar të përdorë forcën kundër Mekës."

Uallahi; ndërkohë që unë po përpiquesha të përmbushja qëllimin e largimit nga ushtria, i hipur mbi mushkë, dëgjova fjalët e Ebu Sufjanit dhe Budejl bin Uerekas, të cilët po ktheheshin në Mekë. Ebu Sufjani thoshte kështu: "Nuk kam parë ndonjëherë as zjarr, as ushtri si kjo e sotmja! Budejli thoshte: "Uallahi ky ishte zjarri i fisit të Khuza'ave! Zjarri që ndizet gjithmonë nga lufta." Ndërsa Ebu Sufjani thoshte: - "As zjarri, as ushtria e Khuza'ave nuk mund të jenë kaq të mëdha, unë e di, janë më pak." Ebu Sufjanin e njoha nga zëri dhe i foli: - "Ebu Handhale!" - Edhe ai më njohu mua, duke thënë: - "Ebu'l-Fadl, ti je?"

- "Po, unë jam!", - u përgjigja unë.

- "T'u bëfshin kurban nëna e babai im, po ti, çfarë kërkon këtu?", - më pyeti.

- "Turp të kesh, o Ebu Sufjan! Ja ku është Profeti në krye të ushtrisë! Uallahi, kurejshët nuk e kanë fare të lehtë kësaj here!"

- "Po mirë, si t'ia bëjmë? Çfarë na këshillon ti?"

- "Po të kapën, ata do të të vrasin. Eja me mua, në mushkën time, të të çoj unë tek ai dhe t'i kërkoji që të të falë."

Ebu Sufjani hipi në pjesën e pasme të shpinës së mushkës dhe u nisëm vetëm pasi ishin larguar të gjithë shokët e tij. Sa herë që kaloja pranë zjarreve të ndezura nga myslimanët, ata pyesnin: - "Kush është ky?" - Kur panë mushkën e Profetit tonë, po thoshin: - "Është mushka

e Profetit tonë, duhet të jetë xhaxhai i tij."

Kur u afrova pranë zjarrit që kishte ndezur Omer bin Hatabi (radijallahu anhu), Omeri (radijallahu anhu) tha: - "Kush është ky?" - dhe bëri të ecë drejt meje. Pastaj, kur pa që në pjesën e pasme të shpinës së mushkës ishte ulur Ebu Sufjani, tha: - "Ebu Sufjani! Armiku i Allahut! Lëvduar qoftë Allahu, që të solli këtu pa lejen e të Dërguarit të Allahut!" - Pastaj u largua dhe shkoi me nxitim për atje ku ndodhej i Dërguari i Allahut. E ngacmova mushkën me thembrat e këmbëve dhe me një shpejtësi pak më të lartë se ajo që ia kalon një njeriu të mbushur, ia kalova Omerit dhe e lashë pas, zbrita nga mushka dhe hyra për tek i Dërguari i Allahut. Në atë kohë hyri edhe Omeri, i cili tha:

- "O Resulullah! Ky është Ebu Sufjani! Allahu i Madhërishëm e pruri vetë, pa e kërkuar ti. Me lejo t'ia ndaj kokën prej trupit!"

- "O Resulullah! Po unë e prura atë këtu duke i garantuar se do ta mbroja unë vetë, nëse do të ishte nevoja.", - thashë unë dhe shkova e u ula pranë Profetit tonë. - "Jo, për Zotin, sonte pranë tij nuk do të qëndrojë asnjë tjetër, veç meje!"

Kur Omeri filloi të këmbëngulte më shumë, nuk durova dhe i thashë:

- "Hesht tani, Omer! Uallahi, po të kishte qenë ndonjë prej bijve të Adijit, me të cilët ke lidhje farefisnore, ti nuk do të kishe folur kështu; ti e di që ai është prej bijve të Abdi Menafit, ndaj edhe i thua këto!"

- "Mbylle gojën, o Abas! Se kënaqësinë që kam ndierë unë kur u bëre mysliman ti, nuk do ta kisha ndierë edhe sikur të ishte bërë mysliman vetë babai im, sepse kënaqësia që ndjeu i Dërguari i Allahut kur u bëre ti mysliman më kënaqi edhe më shumë se sa po të ishte i gjallë Hatabi dhe të hynte në Islam.", - reagoi Omeri (radijallahu anhu).

Aty reagoi Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem):

- "Hajde, o Abas! Merre atë dhe çoje në çadrën tënde dhe kur të agojë sille tek unë." Kështu, unë e mora Ebu Sufjanin në çadër dhe ai e kaloi natën bashkë me mua. Kur agoi, shkova tek i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), i cili, kur e pa Ebu Sufjanin, tha:

- "Turp të kesh, o Ebu Sufjan! A nuk ka ardhur koha që të dëshmosh edhe ti

se nuk ka zot tjetër përveç Allahut, që meriton të adhurohet?!”

- “T’u bëfshin kurban nëna dhe babai im! Sa njeri bujar që je ti! Je kaq i butë dhe i dashur! Dhe je i lidhur dhe i respekton kaq shumë të drejtat e të afërmve! Edhe kur mendoja se ka edhe zota të tjerë, veç Allahut, pandehja se ata mund të më vinin në ndihmë për gjëra të caktuara.”, – u përgjigj Ebu Sufjani.

- “Ah, mor Ebu Sufjan! A nuk ka ardhur ende koha që të pranosh se unë jam i Dërguari i Allahut?”

- “Sa njeri i butë që je ti dhe, për më tepër, trim! Vështirë të gjesh një njeri që të jetë kaq shumë i lidhur me familjen! Uallahi, deri më sot, kam pasur disa dyshime dhe shumë pyetje në kokë.”

Abasi (radijallahu anhu) tregon: - “Shiko, Ebu Sufjan! Nëse të vjen ndopak keq për veten, pranoje Islamin para se të të pritët koka! Hajde, dëshmo se nuk ka zot tjetër, veç Allahut, që meriton të adhurohet, dhe se Muhamedi është profeti i Allahut.”, – i thashë unë Ebu Sufjanit. Dhe, me t’i thënë kështu, Ebu Sufjani dëshmoi me të vërtetë dhe u bë sakaq mysliman.

Në vijim Abasi (radijallahu anhu) i tha kështu Profetit tonë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem): - “O Resulallah! Ebu Sufjani është njeri që i pëlqejnë shumë nderimet, lavdërimet dhe privilegjet, sikur ta përgëzosh me ndonjë gjë që do ta bënte atë të ndihej krenar!”

- “Po mirë, kushdo që hyn në shtëpinë e Ebu Sufjanit, ta dijë se atje do të jetë i sigurt, ashtu siç është i sigurt kushdo që shkon në shtëpinë e vet dhe e mbyll derën. I sigurt është edhe ai që hyn në Xhaminë e Shenjtë.”

Kur Ebu Sufjani u ngrit në këmbë, për t’u kthyer, Profeti ynë i dashur (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) tha:

- “Abas! Merre dhe çojë në ndonjë shteg në rrugën e malit dhe mos u largoni nga lugina, që të shohë ushtrinë e Allahut, kur

të kalojë së andejmi!”

Dolëm bashkë. Ashtu siç më pati urdhëruar i Dërguari i Allahut, e çova Ebu Sufjanin në një vend përgjatë luginës, nga ku mund të shihnim ushtrinë teksa kalonte atypari. Fiset filluan të kalonin të gjitha përpara Ebu Sufjanit, një e nga një, secila me bajrakun e vet. Sa herë që kalonte ndonjë nga fiset që kishin pranuar Islamin, Ebu Sufjani thoshte: - “Po këta, kush janë?” - Dhe unë i thosha, “bijtë e Sulejmanit”, e ai më përgjigjej duke më pyetur:

- “Po ç’problem kemi ne me bijtë e Sulejmanit, që ata po vijnë sot deri këtu?”

Sa herë që kalonte ndonjë nga fiset Ebu Sufjani bënte të njëjtën pyetje dhe unë i përgjigjesha, “bijtë e filanit”. E ai më thoshte:

- “Po ç’problem kemi ne me ta, që kanë ardhur deri këtu?” Kështu kaluan të gjitha fiset një e nga një. Më në fund, erdhi tabori i atyre që kishin veshur parzmorë hekuri, e që nuk u dallohej asnjë pjesë tjetër e trupit, veç syve, të cilët përbëheshin nga Muhaxhirët dhe Ensarët, e që mes tyre ishte edhe Resulullahu, që kaluan me gjithë lavdinë dhe madhështinë e tyre. Ebu Sufjani tha: “Subhanallah! Po këta, kush janë kështu?”

- “Ndërsa këta janë grupi i Muhaxhirëve dhe i Ensarëve, mes të cilëve është edhe i Dërguari i Allahut.”, – iu përgjigja unë.

- “O Ebu’l-Fadl, uallahi këtyre nuk mund t’u dalë askush përballë, pasi askujt nuk i mjafton forca për t’u përballur me ta. Lëvduar qoftë madhështia e shtetit që ka ngritur djali i vëllait tënd!”, – tha Ebu Sufjani.

- “Jo, ai nuk ka ngritur as shtet, as mbretëri; kjo është profetësia e tij.”, – i thashë unë.

- “Po, mirë, ashtu qoftë!”, – m’u përgjigj ai.

- “Tani nisu për te njerëzit e tu!”, – i thashë unë.

U largua. Kur mbërriti pranë të afërmve

të tij, Ebu Sufjani filloi të bërtiste duke thënë: - "O Kurejshë! Ky që po vjen është Muhamedi! Ai po vjen dhe ka mbledhur një forcë të atillë, së cilës ajo pak forcë që keni ju nuk mund t'i bëjë ballë. Kushdo që hyn në shtëpinë e Ebu Sufjanit do të jetë i sigurt, pasi do t'ia garantoj unë jetën."

Kur dëgjoi këto fjalë, gruaja e tij Hindi u çua menjëherë në këmbë, e kapi për mustaqesh dhe klithi:

- "Vriteni këtë poshtërsirë! Nuk arriti të mbronte dot as familjen e tij!"

- "As mos të të shkojë nëpër mend! Të mos ju mashtrorë kjo grua! Po ju them të vërtetën, forca me të cilën po vjen Muhamedi është aq e madhe, sa që ju nuk mund t'i bëni dot ballë. Kushdo që hyn në shtëpinë e Ebu Sufjanit të ndihet i sigurt për jetën.

- "Turp të të vijë! E ku na mjafton ne vetëm shtëpia jote?", - i thanë ata. Pastaj, duke u transmetuar atyre fjalët që i kishte thënë i Dërguari i Allahut, Ebu Sufjani tha kështu:

- "Edhe ata që hyjnë në shtëpitë e tyre dhe e mbyllin derën nga brenda mund të ndihen të sigurt, se nuk do t'i prekë askush." Kaq u tha dhe të gjithë njerëzit u shpërndanë, ca nëpër shtëpitë e tyre, ca nëpër faltore.¹

Ai që e transmeton këtë histori thotë:

- "Në taborin e Profetit tonë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) kishte plot dymijë ushtarë të veshur vetëm në hekur. Resulullahu flamurin ia kishte dhënë Sad bin Ubades (radijallahu anhu). Në krye të tyre qëndronte Sadi dhe teksa po kalonte pranë Ebu Sufjanit, me sanxhakun e Profetit tonë në duar, i tha atij këto fjalë:

- "O Ebu Sufjan! Sot është ditë lufte! Sot është dita që lejohet derdhja e gjakut! Kjo është dita që Allahu i Madhërishtëm poshtëroi kurejshët!"

Në atë kohë, nga përballë po vinte i Dërguari i Allahut. Pikërisht kur u afrua

1. Taberani, Mu'xhemu'l-Kebir 7/76 (6419).

tek Ebu Sufjani, Ebu Sufjani tha:

- "O Resulullah! Çfarë ke urdhëruar, që të vritet populli yt? Sadi dhe ata që ishin krah tij, kur po kalonin përpara meje, më tha:

- "O Ebu Sufjan! Sot është ditë lufte! Sot është dita që lejohet derdhja e gjakut! Kjo është dita që Allahu i Madhërishtëm poshtëroi kurejshët." Për hir të Allahut, unë të kërkoj të tregohesh i mëshirshëm me popullin tënd. Nuk ka dyshim se ti je më i miri ndër njerëz, e nuk ka tjetër njeri që të jetë më i drejtë se ti me njerëzit e vet!"

Atëherë, Abdurrahman bin Aufi dhe Osman bin Affani thanë:

- "O Resulullah! Nuk jemi të sigurt se Sadi nuk do t'i sulmojë kurejshët!", - duke i shprehur shqetësimin e madh që kishin të Dërguarit të Allahut.

Pasi i dëgjoi Abdurrahmanin dhe Osmanin (radijallahu anhuma), Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) tha:

- "O Ebu Sufjan! Sot është dita e mëshirës, sepse kjo është dita që Allahu i Madhërishtëm vendosi t'i lartësojë kurejshët."

Pastaj Profeti i Lëvduar i dërgoi lajm Sadit, se ia kishte hequr detyrën e komandantit. Dhe që të mos i thyhej zemra, e urdhëroi që sanxhakun t'ia jepte të birit, Kajsit. Sadi u tha atyre se nuk do ta dorëzonte atë flamur pa i ardhur një shenjë nga vetë Profeti ynë. Andaj, Profeti i profetëve (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dërgoi çallmën e tij. Kur Sadi mori në dorë çallmën, sanxhakun ia dorëzoi të birit, Kajsit.²

**Shkëputur nga libri "Jeta e Sahabëve 1"
M. Jusuf Kandeheui
Botim i KMSH**

2. Ibni Kethir, el-Bidaje 4/291.

Metodologjia e Ebu Hanifes në nxjerrjen e dispozitave



Metodologjinë shkencore të nxjerrjes së dispozitave të sheriatit Islam, e përcakton dhe e sqaron vetë Ebu Hanifja, kur thotë:

"Unë vepra sipas Librit të Allahut, e nëse problemin nuk e gjej aty, vepra sipas Syneetit të Pejgamberit a.s., e nëse edhe aty nuk gjej zgjidhje, atëherë vepra me fjalët e sahabeve duke e marrë fjalën e njërit dhe duke e lënë fjalën e tjetrit, por nuk largohem prej fjalëve të tyre që të marrë fjalët e të tjerëve, kurse sa i përket tabiinëve, ata nuk më obligojnë me asgjë, ata janë burra edhe ne jemi burra, pra unë bëj ixhtihad ashtu siç kanë bërë ixhtihad edhe ata."

Kjo argumenton se burimet e sheriatit islam sipas metodologjisë së Ebu Hanifes janë: Kur'ani, Syneti, Ixhmai, që nënkupton se Kijasin, Istihsanin dhe Urfin, si burime të sheriatit islam, i përdorte vetëm në raste kur nuk gjente zgjidhje për ndonjë çështje në burimet e mëparshme. Ky fakt hedh poshtë pretendimin e atyre që akuzuan Ebu Hanifen se ka përdorur ixhtihadin duke lënë mënjanë Synetin e Pejgamberit a.s. Prandaj për këtë çështje është e kotë të flitet më shumë.

Imam Ebu Hanifja ishte i pari i cili u mor me radhitjen e haditheve sipas kapitujve të shkencës së fikhut, duke filluar prej pastërtisë, namazit etj.

Ebu Hanifja ndërroi jetë në mes të muajit Sheval të vitit 150 H/767M. Ai që e përgatiti dhe pastroi xhenazen e tij tha: "Allahu të mëshiroftë dhe të faltë! Nuk e ke prishur Ramazanin për tridhjetë vjet, për dyzet vjet nuk je mbështetur natën që të pushosh, i ke lodhur ata që do vijnë pas teje dhe i ke rraskapitur lexuesit (me aftësinë tënde)."

Etapat e zhvillimit të fikhut Hanefi

Ashtu si çdo shkollë tjetër juridike, edhe kjo shkollë ka kaluar nëpër etapat e saj të zhvillimit. Nëse e analizojmë me vëmendje funksionimin e shkollës juridike hanefite, me lehtësi mund të konstatohet se kjo shkollë ka kaluar nëpër tri faza kryesore:

Faza e parë

Etapat e formimit dhe e zhvillimit të kësaj shkolle përfshijnë periudhën kohore prej Ebu Hanifes, nxënësve të tij e deri te vdekja e dijetarit të famshëm Hasan b. Zijad El-Lu'luuj në vitin 204H. Imam Ebu Hanifja nuk kishte shkruar vepra me dorën e vet, sepse qëllimi i tij nuk ishte formimi i ndonjë shkolle apo doktrine të veçantë nga lëmi i fikhut, porse ishin nxënësit e tij ata që rregullisht i regjistruan mendimet e Ebu Hanifes, kur ai i prezantonte në mexhlisin (kuvendin) e diturisë. Nxënësi që më së shumti i kushtoi kujdes kësaj çështjeje ishte Imam Muhamed b. Hasan Esh-

Shejbani, i cili i regjistroi dhe i përpiloi veprat që në shkollën juridike Hanefi njihen me emrin "Dhahiru err-rivaje".

Çështjet e fikhut, të cilat paraqiten në këto gjashtë libra të titulluar "Dhahiru err-rivaje", janë çështje të transmetuara nga themeluesit e medhhebit: Imam Ebu Hanifja, Imam Ebu Jusufi, Imam Muhamedi; e këtyre u bashkëngjiten edhe Imam Zuferi dhe Imam Lu'luuj, porse në të shumtën e rasteve janë mendimet e tre të parëve. Roli, rëndësia, pozita dhe fuqia argumentuese e këtyre veprave janë të shkallës së parë në mbështetje, që nënkupton se nëse gjejmë një çështje të fikhut që kundërshtohet me mendimin që ekziston në "Dhahiru err-rivaje", atëherë për bazë merret mendimi që është i regjistruar në "Dhahiru err-rivaje".

Faza e dytë

Periudha e thellimit, rritjes dhe zhvillimit të kësaj shkolle që fillon me vdekjen e Lu'luit në vitin 204/820 e vijon deri te vdekja e Imam En-Nesefij 710/1310. Kjo periudhë karakterizohet prej përfundimeve të dijetarëve më të shquar e që konsiderohen themelues të medhhebit, prandaj çështjet e fikhut ku pajtohej mendimi i imam Ebu Hanifes me nxënësit e tij janë të regjistruara në gjashtë veprat e quajtura "Kutubu edh-dheuahir". Nëse kishte mospajtime mes imamatit dhe nxënësve, në fund për bazë merrej mendimi i imamatit. Te dijetarët e mëvonshëm u ndryshua kjo bindje, sepse veprohej sipas thënies së imamatit në raste të mospajtimit, atëherë kur njëri prej dy nxënësve të tij, Ebu Jusufi apo Imam Muhamedi pajtohen me mendimin e imamatit. Pra, në rastin kur në një mendim pajtoheshin dy nxënësit, kurse imami kishte mendim tjetër, atëherë parësor mbetet mendimi i dy nxënësve, normalisht nëse është çështje që mund të ndryshohet përmes ixhtihadit.

Faza e tretë

Periudha e vendosmërisë fillon me vitin 710 e vijon deri më sot. Në dy etapat e para u vunë dhe u përforcuan themelet e medhhebit Hanefi, andaj nga shekulli i tetë hixhri e më vonë dijetarët sillëshin dhe mbështeteshin në veprat e mëparshme duke i sqaruar parimet dhe kriteret që ekzistonin në ato vepra. Nga veprat që janë më të njohura në këtë kohë është "Hashijetu ibn Abidin", që në hollësi shpjegon edhe mendimin mbështetës gjatë dallimeve mes themeluesve të medhhebit.

Jusuf Zimeri



OSMAN MYDERRIZI
(1891-1973)

**MËSUESI I POPULLIT, VEPRIMTARI
ATDHETAR, STUDIUESI I SHKËLQYER**

“Osman Myderrizi i përket atij brezi intelektualësh, prej të cilëve koha kërkoj të jepnin në disa fusha të dijes dhe të jetës. Ai ka meritën e pionierit, shkencëtarit të parë, që çeli rrugën e gjerë të studimit të letërsisë shqipe me alfabet arab.”

Prof. dr. Jorgo Bulo

Fakti kuptimplotë se një shkolle dhe një rrugë në Tiranë u është vënë emri i nderuar “Osman Myderrizi”, më bën të besoj se historia dhe ndërgjegjja kombëtare e sociale “mënon (vonon), por nuk harron”.

Osman Myderrizi renditet me dinjitet në radhët e para ndër intelektualët më të shquar të vendit tonë. Në personalitetin e tij qëndrojnë harmonikisht figura e nderuar e mësuesit të popullit, vendosmëria e veprimtarit atdhetar, tejpashmëria vështrimore e gazetarit me kulturë të gjerë, pasioni dhe këmbëngulja e studiuesit të shkëlqyer të gjuhës, letërsisë e traditave më të vjera të popullit tonë.

Disa radhë për jetën dhe veprimtarinë e O. Myderrizit

O. Sali Myderrizi lindi në Tiranë më 1891, në një familje me tradita atdhetare e fetare. Të parët e tij janë marrë me arsimin e kohës, prandaj kishin mbajtur mbiemrin Myderrizi (Yrfi myderriz – mësues, profesor i zakonshëm). Mësimet e para i mori në vendlindje, ku u njoh me elementë fillestare të gjuhëve shqip, turqisht, arabisht dhe persisht. Të mesmen e kreu në Shkodër, në gjuhën turke, ku u thellua në gjuhësi, teologji dhe shkenca. Mësoi bazat e osmanishtes, gjuhës së vjetër turke me alfabet arab. Duke shkëlqyer në mësimet dhe sjellje, djaloshi të zellshëm iu krijua mundësia të shkonte në Stamboll, kryeqendër e Perandorisë Osmane, në Shkollën e Lartë të Studimeve Islame, ku u specializua për pedagogji, histori dhe gjuhësi, duke përvetësuar bazat shkencore dhe metodat më bashkëkohore në këto fusha. Filloi të hedhë në letër shënimet e para të orientalistit të ardhshëm.

Pas kthimit nga Turqia, ku studioi për disa vjet, më 1913 hapi në Ndroq, në rrethinat e Tiranës, të parën shkollë të rregullt shqipe në këtë qark. Më vonë, më 1917, me nismën e Osmanit u krijua Shoqëria Politike, Sociale e Atdhetare “Dituria” dhe pas disa vitesh, më 1920, ai botoi e drejtoi të parën gazetë

në Tiranë “Zani i Ri”; ndërsa më 1923 botoi gazetën “Populli”, organ i Partisë Popullore, si anëtar i asaj partie që ishte.

Veprimtaria politike e Osman Myderrizit kalon në disa faza, kur më 5 prill 1921, u zgjodh deputet i Tiranës në Këshillin Kombëtar, pas Kongresit të Lushnjës, ku Tirana u caktua për kryeqytet. Më vonë, më 27 dhjetor 1923, u bë anëtar i Kuvendit Kushtetues, në mes të 100 deputetëve nga i gjithë vendi. Kryengritja e qeshorit 1924 e gjeti në krahun opozitar dhe pas dështimit të saj dënohet dhe emigron. Amnistia e pas disa viteve e kthen në atdhe, të frikur, të rrezikuar dhe të kërcënuar nga rreziqe të shumta, por të armatosur me më shumë dije e kulturë.

Më 1928 bëhet nëndrejtor i gazetës “Telegraf” në Tiranë dhe më vonë drejton gazetën “Shekulli i Ri” në Durrës, ku shkruan e ndreq qindra artikuj, shkrime e studime. Punon gjithashtu për dhjetëra studime në gjuhësi, letërsi, histori, fjalorë, etj.

Viti 1934 e gjen mësues në Berat, vendbanim i lashtë, ku pat jetuar e shërbyer Nezim Frakulla, nga Berati, shekuj më parë.

Frytet e punës së O. Myderrizit u dukën me botimin e artikullit “Albanopolis – Kryeqendra e Shtetit të Arbërit”, viti 1933.

Në vitin 1937 boton të parën histori të shkruar për Tiranën, një libër me 75 faqe, tip guide, “Tirana 1604-1937”, pastaj vjen në Hylli i Dritës, Shkodër 1943, studimi “Emni i Shqipnisë në Kohën e Mesme”, i cili pasohet nga libri “Fonologjia dhe Morfologjia” e mësuesit, i cili hartoi shqipen e re.

Nga viti 1939 deri më 1943 Osman Myderrizi internohet si antifashist në Arezzo in Tuscany.

Me rëndësi të veçantë janë botimet e librave “Fonologjia dhe Morfologjia” dhe teksti mësimor “Gramatika e Re e Shqipes.”

Më vonë u bë pionier i studimeve orientale shqiptare, zbulues i shkrimeve të bejtexhinjve (vjershëtorëve), tekstet e vjetra shqipe me alfabet arab, por pas vendosjes së The Atheist Campaign (Fushatës Ateiste), më 1967, punët e tij u nënvleftësuan dhe u shkatërruan nga harresa.

Më 1997, si mësuesi i parë i Tiranës, mori titullin “Mësues i Popullit” dhe më 2000-ën u titullua “Simbol i Qytetit të Tiranës”

Kërkues shkencor me rëndësi kombëtare
Në fushat e studimeve të gjuhësisë emri

i Osman Myderrizit renditej përkrah emrave të njohur A. Xhuvani, E. Çabej, Sh. Demiraj, etj.

Lufta e Dytë e Përbotshme e gjeti Osman Myderrizin në valën e punës kërkimore-shkencore, pasi ishte kthyer nga internimi ku vuajti shumë, por edhe u njoh me gjuhët dhe kulturën bashkëkohore evropiane. Fill sapo mbërriti në atdhe, hartoi dhe botoi më 1944 "Gramatika e Gjuhës Shqipe" në versionin gegnisht.

Nga viti 1947 deri më 1966, shkencëtari dhe studiuesi i talentuar O. Myderrizi ishte kërkues shkencor në Institutin e Shkencave (më vonë Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, më vonë pjesë e Akademisë së Shkencave). Më 1954 u krijua një grup pune shkencëtarësh të gjuhësisë për hartimin e një Fjalori të Gjuhës Shqipe bashkëkohore, pjesë e të cilit ishte edhe Osmani, ndërkohë që sapo kishin dalë nga shtypi "Fjalori i vjetër shqip-turqisht" dhe "Fjalori Filologjik", të cilët i përkasin vitit 1950.

Fusha kryesore e studimeve të tij ishte: Analiza e teksteve të Bejtexhinjve (vjershëtorëve), - grupim i shkrimtarëve shqiptarë me tradita islame. Ai i gjurmoi, kërkoi, gjeti, transliteroi, transkriptoi, analizoi dhe i studioi thellësisht ato.

Drejt zbulimeve të mëdha

Interesat e gjera shkencore të Osman Myderrizit dhe formimi i tij i plotë si orientalist, e drejtuan dhe e orientuan vetëvetishëm shkencëtarin e zellshëm në një fushë djerr, shumë pak të lëvruar të kulturës shqiptare: Letërsia shqipe me alfabet arab. Gjuhëtari i shquar kishte përparësinë e zotërimit të mirë të osmanishtes së vjetër. Për të kuptuar dhe studiuar letërsinë e vjetër, filologët janë të detyruar të mësojnë gjuhë të tilla si latinishten, greqishten e vjetër, osmanishten, etj., sepse krijimtaria

e asaj kohe është realizuar në ato gjuhë. Në fushën e studimeve shqiptare, studimi i kësaj letërsie e kulture përbëjnë kontributin themelor të këtij shkencëtari, për të cilën ai shpenzoi pjesën më të madhe të energjive të tij, me punë të palodhur për të nxjerrë në dritë përpara botës dhe për të studiuar një krijimtari gati të harruar, dorëshkrime të nënvlerësuara e të braktisura, të mbuluara nga pluhuri i kohës nëpër xhami, teqe e tyrbe, ku kishte rrezik që ato të humbisnin përgjithmonë, sidomos pas shpërthimit të fushatës famëkeqe të luftës kundër fesë e institucioneve fetare. Kjo letërsi kishte qenë dukuri mbizotëruese e procesit kulturor gjatë shekujve XVII, XIII e në vazhdim dhe njihet si zbulim i Osman Myderrizit.

Pararendës të këtij zbulimi ishin korifenjtë e Rilindjes sonë Kombëtare, Naim e Sami Frashëri. Në qershor 1882, ishte Sami Frashëri që u orvat të botonte Bejtexhinjtë, duke përdorur kopje të Divanit të Nezim Farkullës, gjetur nga Abdullah Ferhati, të kopjuar nga dervish Sali Ashiku në Tepelenë, më 1847. Vjershëtorë të shkëlqyer e të vërtetë i pati quajtur poeti i madh Naim Frashëri, Bejtexhinjtë.

Po ashtu, të dhënat që ka sjellë Hahni e Mejeri dhe më vonë Z. Jubani e J. Vreto për disa shkrimtarë bejtexhinj, janë të gjetura nga burime të tjera dhe shpesh fragmentare, të shkëputura. Kërkimet, zbulimet, analizën dhe studimin e tyre O. Myderrizi i vuri mbi baza të shëndosha shkencore filologjike.

Më 1941 Namik Selmani dhe Filip Fishta botuan veprën përgjithësuese "Shkrimtarë shqiptarë" v. I-rë, ku në kapitullin "Shkrimtarë të vjetër myslimanë" shënuan disa të dhëna për N. Frakullën dhe M. Çamin, duke riprodhuar disa tekste të shkurtra nga krijimtaria e tyre, ndërkohë që nga paralufta "Dituria" e Selanikut, më 1916, e cila doli edhe në Tiranë më 1926, si dhe "Zani i Naltë"

dhe "Kultura islame", botuan disa të dhëna dhe fragmente tekstesh nga Bejtexhinjtë, për meritë të Abdullah Ferhatit.

Afro 20 vite të jetës së tij shkencore O. Myderrizi i shpenzoi me dashuri, përkushtim dhe pasion për gjurmimin, botimin dhe studimin e letërsisë së vjetër myslimane, të shpërndarë në të gjithë vendin dhe jashtë kufijve tanë shtetërorë, nga jugu në veri: Konispol, Frashër, Kolonjë, Berat, Elbasan, Tiranë, Shkodër, Tetovë, Gjakovë, Vuçitërnë, Prishtinë, etj., duke kërkuar jo vetëm në konakët e teqeve, por edhe nëpër arkiva e biblioteka, në kujtesën e hoxhallarëve, dervishëve, shehlerëve dhe njerëzve të tjerë, të cilët mbanin mend vargje nga divanet, mevludet, ilahitë, gazelet, kasidetë, të përhapura nga rrymat e kohëve.

Kjo punë rraskapitëse, plot mund e pasion nuk e pati fatin të botohej sistematikisht dhe e plotë.

Fillimisht O. Myderrizi hulumtoi, komentoi, transliteroi dhe transkriptoi variante të Divanit nga N. Frakulla (Berati), pastaj Mevludin e H. Z. Kamberit dhe vjersha të tjera me rëndësi të këtij poeti mjaft kritik për kohën; vargje të S. Naipit, të M. Çamit, poemat "Muftarnameja" dhe "Hadikaja" të Shahin e Dalip Frashërit. Më vonë dolën dorëshkrime të autorëve të panjohur nga Gjirokastra, nga H. Ali Ulqinaku u gjend fjalori shqip-turqisht dhe shumë tekste të tjera në poezi e prozë fetare shqipe. Me mijëra faqe janë dorëshkrimet e përpunuara filologjikisht nga shkencëtari ynë i shquar, të cilat ndodhen të ruajtura në Arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, fragmente nga veprat e Muçi Zadesë, Zenel Bastarit, Sheh Sulejman Temanit, Ismail Pasha Velabishtit, Sh. Ahmet Elbasanit, Tahir Skënderasit, H. Et'hem Tiranës, Tahir Popovës, Mulla Hysen Dobraçit, M. Sali Patës, Mehmet Margëlliçit, etj., duke përbërë një numër të madh emrash

dhe veprash të gjetura dhe të komentuara.

Më 1954, O. Myderrizi përfundoi monografinë "Literatura shqipe me alfabet arab", e cila mbeti dorëshkrim që ruhet në Arkivin e I.H.L. Një pjesë e kapitujve të studimit u botuan në revistat shkencore të kohës, që zgjuan mjaft interes dhe shërbyen si bazë për hartimin e librit të parë të "Historia e Letërsisë Shqipe", që doli më 1959.

Më pas shkencëtari i shquar përgatiti për shtyp korpusin e veprave më të shquara të shkrimtarëve myslimanë, prej së cilës botoi një pjesë të vogël për shkak të paragjytimeve të kohës.

Pas O. Myderrizit, ose njëkohësisht me të, të tjerë studiues u morën me studimin e prodhimit letrar të bejtexhinjve, pak prej tyre në Shqipëri, si Hafiz Ibrahim Dalliu, Ibrahim Hasanaj, etj., por më së shumti nga studiues të njohur kosovarë si I. Ajeti, M. Krasniqi, Hajdar Salihu, Muharrem Piraku, etj., të cilët e zgjeruan dukshëm gjeografinë e kësaj prodhimit me rëndësi historike e kulturore.

U takon studiuesve të rinj dhe shkencëtarëve të së ardhmes ta bëjnë objekt të një shqyrtimi tërësor letërsinë myslimane të shqiptarëve, si një hallkë me rëndësi të procesit letrar, kulturor e social, si një krijimtari që me lidhjet e saj të brendshme me kulturat e mëdha të orientit dhe me filozofinë islame, e pasuroi dhe e zbukuroi letërsinë dhe kulturën shqiptare në tërësi. Kjo do të ishte një shenjë e shprehjes së nderimit dhe respektit për jetën dhe veprën e Osman Myderrizit, këtij shkencëtari të shkëlqyer e të përkushtuar, të cilit i takon merita e të qenit pionier, rrugëçelës në udhën e gjerë të studimeve në këtë fushë.

Dr. Hysen Kobellari

Muhamedi (a.s)

Krenaria e Njerëzimit



"Muhamedi a.s. njeri i shkëlqyer, dritë e Zotit. Në histori kërkova shembullin e një njeriu të shkëlqyer e atë e gjeta te pejgamberi Muhamed." **Johan Volfgang Gëte**

"Fjala e tij është vetëm zë i së vërtetës, zë që del nga sferat më të larta shpirtërore. Ai nuk është gjë tjetër veçse një meteor që ka ndriçuar gjithë botën..." **Thomas Carlyle**

Muhamedi a.s. është krenaria e të gjithë rruzullit tokësor, një zotëri i nderuar, i respektuar, i famshëm, i veshur me virtyte të ndritshme e pasqyrë për të gjithë muslimanët shërben rruga e tij profetike. Realisht, ky kandil ndriçues nderohet dhe respektohet edhe nga besime të ndryshme, nga shkencëtarë dhe dijetarë të mëdhenj, nga studiues dhe filozofë të shquar, nga figura të njohura të letërsisë botërore. Në një enciklopedi angleze citohet: "Një lumë detajesh nga burime të hershme, tregojnë që ai ishte njeri i drejtë dhe i ndershëm, i cili pati fituar respektin dhe besnikërinë e të tjerëve, që ishin të ndershëm dhe të drejtë." Allahu e ka dërguar atë si mëshirë për botët, për të përcjellë mesazhin hyjnor me prova dhe argumenta të qarta, e për ta bërë këtë mesazh dëshmues të kujtdo që e dëgjon, dhe do ta dëgjojë deri në Ditën që Krijuesi do të trashëgojë tokën dhe çka ka në të, Ditën e Kijametit. Jeta e këtij margaritari të çmuar është e mbushur me plot vlera e virtyte të jashtëzakoshme, krejt të veçanta e të gjitha këto të mëshiruara vetëm tek një njeri. Rreth tij tuboheshin për të marrë dije e për të përfituar nga fjalët e tij xhevahirë të çmuar të gjithë njerëzit pavarësisht nga gjuha, populli, ngjyra, shtresa sociale a kulturore që i përkisnin. Aromën e këtij trëndafili të Medinës duhet ta marrin të gjithë njerëzit bashkëkohore e të "civilizuar" për t'u veshur sadopak me mantelin e moralit, devotshmërisë e vlerave të pastra të mëshirës e humanitetit, që fatkeqësisht po humbasin me kohën. Muhamedi s.a.v.s ishte i butë e i mëshirshëm me të gjithë njerëzit, kafshët, insektet e çdo gjë tjetër që ka krijuar dora e Allahut. Butësia dhe dhembshuria e tij përfshinte të varfërit, bonjakët, fqinjët, familjen si dhe ata që i kishin shpallur haptazi armiqësi. Thotë Allahu xh.sh në Kur'anin Fisnik:

"Ne të dërguam ty (Muhammed) vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat." (El-Enbija:107) Profeti ynë i dashur Muhamedi s.a.v.s ishte një njeri i dimensioneve të shumta dhe shquhej për thjeshtësinë dhe zgjuarsinë e tij. Në një hadith të bukur Krenaria e Njerëzimit ka thënë: "Allahu e lartëson atë që tregohet i thjeshtë." dhe kjo vlerë kaq e çmuar mëshirohet dhe paraqitet më së miri tek Profeti ynë i nderuar. Një tjetër dimension i zgjuarsisë profetike të profetit Muhamedi s.a.v.s është besnikëria, që dëshmon për profetësinë e tij të padiskutueshme. I dërguari i Allahut me bindjen e tij absolute, me besimin e tij të patundur dhe devotshmërinë e jashtëzakoshme argumentoi dhe mbrojti qëndrimin dhe mesazhin për të cilin ishte dërguar. Prej 14 shekujsh, Profeti Muhamedi s.a.v.s e pasuroi njerëzimin me besim e iman, me moral e plot vlera të vjera dhe padyshim

që shembullin e tij duhet ta ndjekin të gjithë, mbarë besimtarët e të veprojnë sipas Sunnetit dhe traditës së tij profetike. Para bijve të Ademit ligjëronte të drejtën, të vërtetën dhe ajetet e bukura të Kur'anit Fisnik, përmes të cilave ky misionar i njerëzimit dhe i të gjithë kohërave shpërndan mesazhin hyjnor, për të ndriçuar njerëzit qoftë edhe pak, sa një dritë e qiririt, për t'i nxjerrë nga injoranca e pashoq, nga errësira që i kish pllakosur në dritën e pashuar të Kur'nit Famëlartë. Me këtë dritë u ndriçua dhe u zbulua gjithësia për të mos u shuar më kurrë, mbizotëroi gazi dhe lumturia për të mos përfunduar më sepse tashmë përmendej Allahu, Një e i Vetëm e lavdërohej Madhëria e Tij. Me moralin, karakterin dhe personalitetin e tij unik, Profeti ynë i dashur s.a.v.s arriti të fitojë zemrat e të gjithë njerëzve, ai u mësuesi i mendjeve, i dashuri i zemrave dhe mbreti i shpirtave. Muhamedi s.a.v.s mund të konsiderohet me të drejtë edhe si shpëtimtar i njerëzimit pasi qëllimi i tij ishte madhështor, nuk synonte të shpëtonte vetëm njeriun, por të gjitha qeniet e Krijuesit nga thellësia e errësirës dhe injorancës, nga asgjëja dhe padituria drejt vlerësimit dhe ngritjes në shkallë më të larta për të fituar vlera, virtyte e për të njohur kënaqësinë e përzetshme. Profeti Muhamedi s.a.v.s është pishtar ndriçues për të gjithë njerëzimin e për të gjithë kohërat, ai është vula e profetëve e për vërtetësinë e profetësisë së tij flet gjithçka e ka shumë argumente. Thotë Allahu xh.sh në Kur'anin Kerim:

"Atë që All-llahu dëshiron ta udhëzojë, ia zgjeron zemrën për (të pranuar) Islamin. Atë që dëshiron ta lërë të humbur, zemrën e tij ia bën shumë të ngusht sikur të ngjitej në qiell. Kështu All-llahu lëshon dënimin mbi ata që nuk besojnë." (El-En'am:125) Ky ajet tregon se njeriu ngushtohet në kraharor sa më lart të ngjitet në lartësitë qiellore. Kjo ndodh për shkak se sa më lart të ngjitesh në shtresat e larta atmosferike, aq më e ulët bëhet trysnia dhe aq më e pakët bëhet sasia e oksigjenit. Ky argument shkencor është vërtetuar vetëm pas ngjitjes së njeriut në qiell në kohët tona moderne përmes teknologjisë së avancuar dhe nuk e ka ditur as dijetari dhe as njeriu i thjeshtë në kohën e Profetit Muhamedi s.a.v.s. Ky argument i bukur hedh poshtë teoritë e disa njerëzve që konsiderojnë Kur'anin vepër të Muhamedit s.a.v.s, kur ky i fundit është vetëm një mesazh i fjalës së Allahut dhe ky argument vetëm një xhevahirët e çmuar të oqeanit të mrekullive të pashtershme të Librit të Shenjtë, Kur'anit. Ky moral e këto veti të shkëlqyera e të vjera të Profetit tonë të dashur s.a.v.s i bëri shumë njerëz të besonin se ky njeri siç thotë Allahu: "Nuk flet prej mendjes së tij", por të ishte Profet i Allahut.

Muhamedi s.a.v.s ishte i pajisur me sjellje fisnike, të folur të ëmbël, gjykim të drejtë dhe elokuencë të qartë. Ky reformator tronditi shpirtat, gjallëroi moralin, lartësoi virtytin dhe ngriti e ndriçoi për të mos shuar kurrë Islamin e pastër dhe të qartë e teuhidin.

Përgatiti: Jonida HOXHA, BA

*Suksesi juaj
Prioriteti ynë*

Mjedise Komode

*Klasa digjitale
Kushte fizike shumë të mira
Klasa me numër të vogël nxënësish*

Arsim Cilësor

*Metoda bashkëkohore të mësimdhënies
Laboratorë për lëndët shkencore
Staf i kualifikuar*

Bursa

*Ekselence
Talenti
Sociale*



facebook.com/medresejatirane
medresejatirane@yahoo.com
069 96 10 210



facebook.com/medresejaelbasan
medreseliriaelbasan@gmail.com
068 47 37 757

VIJOJNË REGJISTRIMET

Për klasën e 10-të
2024-2025

MOS HARRONI
Provimi është
DITËN E SHTUNËN
27 PRILL
Ora 10:00

